

MESAZH PËR
TË SËMURËT

Mesazh për të Sëmurët

(Hastalar Risalesi – Arnavutça)

Autor: **Bediüzzaman Said Nursî**
Shqipëroi nga arabishtja: **Jusuf Salkurti**

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.
Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të kopjohet, ruhet në
sistem rikthimi apo të transmetohet në çfarëdo forme ose
me çfarëdo mjeti, elektronik apo mekanik, pa lejen
paraprake me shkrim të përkthyesit.

Botues: **Sözler Neşriyat**
Vendi i botimit: **Istanbul, Turqi**

Shtypi: **İmak Ofset Basım Yayın**
Vendi i shtypit: **Istanbul, Turqi**

Viti i botimit: **2026**

Kontakt:

www.sozler.com.tr

zarif_1997@hotmail.com

Facebook: Risale-i Nur Shqip (Ahmed Ben)

Nga koleksioni i Risale-i Nurit

MESAZH PËR TË SËMURËT

AUTOR

Said Nursî

Sözler®

2026

“Dhe Ai më ushqen dhe më jep të pi.
Dhe kur sëmurem, Ai më shëron.”

SHKREPTIMA E NJËZET E PESTË

Njëzet e Pesë Ilaçe

[Kjo trajtesë përbëhet nga njëzet e pesë 'ilace'. Kjo u shkrua si një balsam, ngushëllim dhe një recetë për të sëmurin, si një vizitë për të sëmurët dhe si një urim për shërimin e tyre të shpejtë.]

Një paralajmërim dhe një shfajësim

Kjo recetë shpirtërore u shkrua me një shpejtësi më të madhe se të gjitha shkrimet e mia të tjera¹, dhe meqenëse nuk gjeta kohë që ta korrigjoja e ta studioja, në kundërshtim me të gjitha të tjerat, ajo u lexua vetëm një herë, dhe ajo me një shpejtësi të madhe si hartimi i saj. Domethënë, ajo ka mbetur në gjendjen e pasistemuar të draftit të parë. Unë nuk e pashë të nevojshme t'i kontrolloja me kujdes gjërat që më kishin ardhur në zemër në një mënyrë të natyrshme, me qëllim që ato të mos prisheshin duke i rregulluar e duke u kushtuar vëmendje të tepruar. Lexuesit dhe veçanërisht të sëmurët nuk duhet të ndihen të shqetësuar e të fyer nga ndonjë shprehje e pakëndshme apo fjalë e fraza të ashpra; më mirë le të bëjnë ata dua për mua.

Said Nursi

¹ Kjo trajtesë u shkrua për katër orë e gjysëm.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

الَّذِينَ إِذَا أَصَابَهُمْ مُصِيبَةٌ قَالُوا إِنَّا لِلَّهِ وَإِنَّا إِلَيْهِ
رَاجِعُونَ * وَالَّذِي هُوَ يُطْعِمُنِي وَيَسْقِينِ وَإِذَا
مَرَضْتُ فَهُوَ يَشفِينِ

Me Emrin e Allahut i Gjithëmëshirshmi,
Mëshirëploti.

“Të cilët thonë kur u bie fatkeqësi, vërtet të
Allahut jemi dhe padyshim tek Ai do të
kthehemi.”²

“Dhe Ai më ushqen dhe më jep të pi. Dhe
kur sëmurëm, Ai më shëron.”³

Në këtë shkreptimë, ne do të shpjegojmë
shkurtazi Njëzet e Pesë Ilaçe të cilat mund të
japin ngushëllim të vërtetë dhe një kurim të
dobishëm për të sëmurët dhe për ata që janë
goditur me fatkeqësi, të cilët përbëjnë një të
dhjetën e njerëzimit.

² Kur'an 2: 156

³ Kur'an, 26: 79-80

Ilaçi i Parë

O i sëmure i pafuqishëm! Mos u shqetëso, bëj durim! Sëmundja jote nuk është lëngatë për ty, ajo është një lloj ilaçi; sepse jeta është një kapital që zhduket; në qoftë se ajo nuk jep fruta, do të humbiste çdo gjë dhe, në mënyrë të veçantë në qoftë se kalon në rehati e në shkujdesje, ajo do të kalonte shpejt. Sëmundja e bën atë kapitalin tënd të fitojë dobi të mëdha. Për më tepër, ajo nuk e lejon jetën tënde të kalojë shpejt, ajo e pengon dhe e zgjat atë, me qëllim që ajo të largohet pasi të ketë marrë frutet e saj. Një tregues se jeta jote zgjatet nëpërmjet sëmundjes është proverba vijuese e përsëritur shumë shpesh:

“Kohët e fatkeqësisë janë të gjata, kurse kohët e lumturisë janë me të vërtetë të shkurtra.”

Ilaçi i Dytë

O i sëmure që të mungon durimi! Ji i duruar! Madje jep falënderime! Sëmundja jote mund t’i transformojë minutat e jetës tënde në barasvlerën e ibadeteve të orëve. Sepse adhurimi është dy llojësh:

I pari është adhurimi pozitiv që mishërohet në kryerjen e namazeve, të duave e të tjera si këto.

I dyti është format negative të adhurimit si sëmundjet e fatkeqësitë. Nëpërmjet këtyre, të goditurit me to kuptojnë pafuqinë dhe dobësinë e tyre; ata i luten Krijuesit të tyre Mëshirëplotë dhe kërkojnë strehim tek Ai; ata manifestojnë adhurimin i cili është i sigurtë dhe pa hipokrizi. Po, ka rrëfenja të shëndosha që pohojnë se,

“Një jetë e cila kalon në sëmundje, konsiderohet si adhurim për besimtarin, me kusht që ai të mos ankohet rreth Krijuesit”.

Madje është vërtetuar në disa rrëfenja të sakta dhe nga ata që zbulojnë realitetet e krijimit se sëmundja e një minuti i disave, të cilët janë krejtësisht të duruar dhe mirënjohës, bëhet e barasvlefshme me adhurimin e një ore për ta; dhe sëmundja e një minuti e disa njerëzve të plotësuar është e barasvlefshme me adhurimin e një dite të plotë për ta. Prandaj, ti nuk duhet të ankohesh për një sëmundje e cila e transformon një minutë të jetës tënde në një mijë minuta që të bën ty të fitosh një jetë të gjatë; përkundrazi ti duhet të japësh falënderime.

Ilaçi i Tretë

O i sëmurë i padurueshëm! Fakti se ato që vijnë në këtë botë largohen në mënyrë të vazhdueshme, të rinjtë plaken dhe, njeriu

vazhdimisht rrotullohet midis vdekjes dhe ndarjes, dëshmon se ai nuk ka ardhur në këtë botë që ai të kënaqë vetveten e të gjejë ëndje.

Për më tepër, ndërsa njeriu është më i lartësuari i qenieve të gjalla dhe i pajisuri më mirë për sa ka të bëjë me gjymtyrët dhe aftësitë, madje ai është prijësi i atyre të gjithëve, mirëpo duke menduar për kënaqësitë e shkuara dhe për dhimbjet e së ardhmes, ai kalon vetëm një jetë pikëlluese e të mërzitshme më të ulët se sa kafshët. Kjo do të thotë se njeriu nuk erdhi në këtë dynja për të kaluar një jetë të mirë, të rehatshme e në ëndje, përkundrazi, duke pasur në pronësi një kapital të madh, ai erdhi këtu të punojë e të bëjë tregti për një jetë të përhershme e të amshuar. Kapitali që i është dhënë njeriut është jeta e tij. Po të mos kishte pasur sëmundje, shëndeti i mirë dhe mirëqënia do të kishin shkaktuar pakujdesi, sepse ato e shfaqin dynjanë të jetë e këndshme dhe bëjnë të harrohet Ahireti. Ato nuk dëshirojnë që të mendohet për vdekjen dhe për varrin; ato e bëjnë kapitalin e jetës të harxhohet në çikërrima e më kot. Ndërsa sëmundja papritmas t'i hap sytë; ajo i thotë trupit: "Ti nuk je i pavdekshëm. Ti nuk liresh në tekat e tua. Ti ke një detyrë; braktise mendjemadhësinë, mendo për të Vetmin i Cili

të krijoj. Dije se ti po kalon për të hyrë në varr, kështu që përgatitu për të!" Kështu, nga ky këndvështrim sëmundja është një udhëzues i besuar dhe një paralajmërues e këshillues i cili nuk të mashtron kurrë. Atëherë nuk duhet të ankohesh prej saj nga ky drejtim, por duhet të përshtatesh në hijet e dhënies së falënderimeve. Dhe në qoftë se ajo është shumë e rëndë, duhet të kërkossh durim nga Krijuesi, xh.sh., që ta përballosh.

Ilaçi i Katërt

O i sëmurë ankimtar! Dije se ti nuk ke të drejtë të ankohesh, por duhet të japësh falënderime dhe të durosh, sepse trupi yt, gjymtyrët dhe aftësitë e holla nuk janë prona jote. Nuk i ke bërë ti ato dhe as nuk i ke blerë nga fabrika të tjera. Kjo do të thotë se ato janë prona e një tjetri, dhe Pronari i tyre vepron mbi pronën e Tij si të dojë.

Ashtu siç tregohet në Fjalën e Njëzet e Gjashtë e cila lidhet me Kaderin Hyjnor, se një mjeshtër shumë i pasur dhe i talentuar, për shembull, e përdor një burrë të varfër si një model me qëllim që të tregojë artin e tij të bukur dhe pasurinë kundrejt një page të caktuar për një periudhë kohe prej një ore. Ai e vesh burrin e varfër me një mantel të zbukuruar e të modeluar me mjeshtëri. Ai e

punon mantelin mbi të dhe i jep atij gjendje të ndryshme. Me qëllim që të shfaqë shumëllojshmëritë e jashtëzakonshme të artit të tij, Ai e pret mantelin, e modifikon, e zgjat dhe e shkurton. A ka të drejtë ai burrë i varfër, i cili punon për shpërblim, t'i thotë atij Përsioni: "Ti po më jep shumë shqetësim, ti po më bezdis shumë me formën që i ke dhënë mantelit, duke më bërë mua një herë të përkulem dhe një herë të rri drejtë"; a ka ai të drejtë t'i thotë Atij se po ia prish paraqitjen e tij të bukur nëpërmjet rregullimit dhe shkurtimit të mantelit i cili e bën atë të bukur? A mundet t'i thotë se ai është mizor dhe i padrejtë?

O njeri i sëmure! Tamam si në këtë krahësim, me qëllim që të shfaqë mantelin e trupit tënd me të cilin Ai të ka veshur, dhe në të cilin ka vendosur shqisët e ndritshme të zbukuruar si syri, veshi dhe mendja, dhe me qëllim që të shfaqë qëndisjet e Emrave të Tij të bukur, Krijuesi i Gjithëlavdishëm të bën ty të rrokullisesh midis gjendjeve të shumta dhe të ndryshojë ty në situata të shumta.

Ashtu siç njihesh ti me Emrin e Tij Er-Rezzak, Furnizuesi nëpërmjet urtësisë, gjithashtu eja ta njohësh Emrin e Tij Esh-Shafi, Shëruesi nëpërmjet sëmundjes tënde. Meqenëse vuajtjet dhe fatkeqësitë shfaqin

dekretet e disave prej Emrave të Tij të bukur, atëherë brenda atyre shkretimave të urtësisë, rrezeve të mëshirës dhe dritave të bukurisë, gjenden shumë shembuj mirësie. Në qoftë se do të ngrihej perdja e sëmundjes, të cilën ti e ke frikë dhe e urren, pas saj ti do të gjeje shumë kuptime të këndshme e të bukura.

Ilaçi i Pestë

O ti që je sprovuar me sëmundje! Nëpërmjet përvojës, unë kam formuar bindjen në këtë kohë se “Sëmundja është një mirësi Hyjnore dhe një dhuratë e të Gjithëmëshirshmit të vetëm.”

Megjithëse nuk jam i denjë për të, gjatë tetë apo nëntë viteve të kaluara kanë ardhur tek unë disa të rinj lidhur me vuajtjen e tyre nga sëmundja duke kërkuar duatë e mia. Unë kam vërejtur se të gjithë ata të rinj të sëmurë kanë filluar të mendojnë më shumë për Ahiretin se sa të rinjtë e tjerë. Ata nuk janë të dehur nga pakujdesia e rinisë. Ata i shpëtojnë vetet e tyre deri diku nga dëshirat shtazore dhe nga pakujdesia.

U kujtoja atyre se unë shoh se këto sëmundjet e tyre, brenda limitit të durimit të tyre janë një mirësi Hyjnore dhe dhuratë prej Tij, xh.sh. Unë gjithashtu thoja: O vëllai im! Unë jam kundër kësaj sëmundjeje tuaj. Unë

nuk ndjej keqardhje as dhembshuri për ty për shkak të sëmundjes tënde saqë të bëj dua për ty. Përpiku të jesh i duruar deri sa sëmundja të të zgjojë ty plotësisht dhe, pasi ajo të ketë përmbushur detyrën e saj, insha-Allah Krijuesi Mëshirëplotë do të të shërojë". Gjithashtu u thoja atyre: "Nëpërmjet sprovës së shëndetit të mirë disa të rinj si ti bëhen neglizhentë, heqin dorë nga pesë namazet e detyruara, nuk mendojnë për varrin, dhe e harrojnë Allahun e Plotëfuqishëm.

Nëpërmjet një kënaqësie të sipërfaqshme prej një ore nga jeta e kësaj bote, ata lëkundin e dëmtojnë jetën e tyre të përhershme dhe madje e shkatërrojnë atë. Ndërsa për shkak të sëmundjes, ti i shikon varrin, tek i cili padyshim do të hysh, dhe banesat e Ahiretit përtej tij dhe vepron në përputhje me to. Atëherë sëmundja jote është si shëndeti i mirë për ty, ndërsa për disa nga shokët e tu, shëndeti i mirë është një sëmundje."

Ilaçi i Gjashtë

O i sëmurë që ankohesh nga dhimbja! Unë të them: Mendo për jetën tënde të kaluar dhe kujto ditët e këndshme dhe të lumtura dhe kohët dëshpëruese e të mërzitshme.

Ti sigurisht ose do të shprehësh me klithmë ose "Oh!" ose "Ah!". Domethënë zemra jote

dhe gjuha ose do të thonë: El-Hamdu lil-lahi vesh-shukru lehu, “Falënderimi dhe lavdërimi i takojnë Allahut”, ose do të thuash “heu, medet!” Vëre me kujdes! Ajo çfarë të bën ty të thërrasësh El-Hamdu lil-lahi vesh-shukru lehu është të menduarit e dhimbjeve dhe e fatkeqësive prej të cilave pate vuajtur më parë; kjo nxit një lloj kënaqësie të tillë saqë zemra jote jep falënderime, sepse ikja e dhimbjes është kënaqësi. Sepse ato dhimbje e fatkeqësi kanë mbjellur, me zhdukjen e tyre, një kënaqësi në shpirt, e cila duke buruar nga të menduarit, derdh -zbraz- nga shpirti lavdërime e falënderime.

Ndërsa ajo çfarë të bën ty të thërrasësh: “oh, medet!” janë kohët e kënaqshme e të lumtura që ke përjetuar në kohët e mëparshme, të cilat me kalimin e tyre mbjellin në shpirtin tënd një dhimbje të vazhdueshme. Kurdoherë që ti të mendosh për to, dhimbja përsëri nxitet, duke bërë që të derdhen hidhërimi e dëshpërimi.

Meqenëse kënaqësia e paligjshme ndonjëherë shkakton vuajtjen e një viti në shpirt dhe me dhimbjen e sëmundjes së një dite kalimtare janë kënaqësitë dhe thevabi i shumë ditëve përveç kënaqësisë që je lehtësuar prej saj dhe prej së cilës ke shpëtuar, mendo për rezultatin e kësaj sëmundje të përkohshme me të cilën ti je goditur tani dhe

për meritat e fytyrës së saj të brendshme. Thuaj: Gjithçka është nga Allahu! Edhe kjo gjithashtu do të kalojë!”, dhe jep falënderime në vend të ankimeve.

Ilaçi i Gjashtë ⁴

O vëlla që mendon për kënaqësitë e kësaj bote dhe vuan pikëllim nga sëmundja! Në qoftë se kjo botë do të ishte e përjetshme dhe në qoftë se nuk do të kishte vdekje në rrugën tonë, në qoftë se erërat e ndarjes dhe të vdekjes nuk do të frynin, dhe në qoftë se nuk do të kishte dimra të shpirtit në të ardhmen e kobshme e të stuhishme, atëherë sigurisht që do të më vinte keq për ty dhe për veten time. Por meqenëse një ditë dynjaja do të na dëbojë prej saj duke thënë: Hajdeni! Dilni prej këtu! Dhe do t'i mbyllë veshët e saj përballë britmave tona, atëherë para se ajo të na dëbojë e të na flakë ne duhet t'i dalim para dashurisë sonë për të, dhe ta braktisim që tani nëpërmjet paralajmërimeve të këtyre sëmundjeve. Ne duhet të përpiqemi ta braktisim atë në zemrat tona para se ajo të na braktisë.

⁴ Kjo shkrepimë më erdhi në një mënyrë të natyrshme dhe dy ilaçe janë përfshirë në ilačin e gjashtë. Ne e kemi lënë atë kështu me qëllim që të mos prishet natyrshmëria e saj; ne nuk e ndryshuam duke menduar se mund të përfshihet ndonjë mister në të.

Po, sëmundja shpreh këtë paralajmërim për ne: Trupi yt nuk përbëhet nga guri e hekuri, por nga materiale të ndryshme të cilat janë gjithmonë të zbuluara para ndarjes, shpërbërjes e kalbjes. Braktise vetëmburrjen tënde, kupto pafuqinë tënde, njihe Pronarin tënd, kuptoji detyrat e tua, dhe mësoje pse ke ardhur në këtë botë!" Sëmundja e shpreh këtë në mënyrë të fshehtë në veshin e zemrës sonë.

Për më tepër, meqenëse kënaqësitë dhe ëndjet e kësaj bote nuk vazhdojnë dhe sidomos në qoftë se janë të paligjshme, ato janë plot dhimbje, të mëkatshme dhe të paqëndrueshme, mos qaj me pretekstin e sëmundjes për shkak se i ke humbur ato kënaqësi. Përkundrazi, mendo për aspektet e adhurimit dhe të shpërblimit në Ahiret që gjenden në sëmundje, dhe përpiqu të marrësh kënaqësi prej tyre.

Ilaçi i Shtatë

O i sëmurë që ke humbur mirësinë e shëndetit! Sëmundja jote nuk e prish kënaqësinë e mirësive Hyjnore, përkundrazi, ajo i bën ato të përjetohen dhe shton kënaqësinë në to. Sepse në qoftë se diçka është e vazhdueshme, ajo e humbet shijen dhe efektin e saj. Madje njerëzit e realitetit thonë:

أَنَّمَا الْأَشْيَاءُ تُعْرَفُ بِأَضْدَادِهَا se gjërat njihen me të kundërtat e tyre.

Për shembull, në qoftë se nuk do të kishte errësirë, drita nuk do të njihet dhe nuk do të përmbante kënaqësi. Në qoftë se nuk do të ishte i ftohti, nuk do të njihet nxehtësia dhe nuk do të kuptohej. Në qoftë se nuk do të ishte uria, ushqimi nuk do të jepte shije e kënaqësi. Po të mos ishte etja e stomakut, nuk do të kishte kënaqësi në pirjen e ujit. Në qoftë se nuk do të ishte sëmundja, shëndeti i mirë do të mbetej pa kënaqësi.

Krijuesi i Gjithurtë e zbukuroi njeriun me gjymtyrë dhe aftësi vërtetë të shumta deri në atë shkallë që ai të mund të përfjetojë e të njohë shumëllojshmëritë e panumërta të mirësive në univers, kjo tregon se Ai dëshiron ta bëjë njeriun të vetëdijshëm për çdo lloj nga mirësitë e tij dhe t'ia bëjë të njohura, ta bëjë atë të mësohet me to dhe ta shtyjë njeriun për të dhënë falënderime të vazhdueshme. Prandaj duhet patjetër që Ai të zbresë sëmundje, lëngata e vuajtje ashtu siç jep shëndet të mirë e mirëqenie.

Unë të pyes: Në qoftë se nuk do të kishte qenë kjo sëmundje në kokën tënde ose në dorën tënde ose në stomakun tënd, a do ta kishe kuptuar ti mirësinë Hyjnore të

kënaqshme e të këndshme të shëndetit të mirë të kokës tënde, të dorës apo të stomakut dhe a do të jepje falënderime? Sigurisht, jo që do të jepje falënderime për të, por madje ti nuk do të kishe menduar për të! Në mënyrë të pavetëdijshme, ti do ta kishe shpenzuar atë shëndet të mirë në pakujdesi dhe ndoshta edhe në shthurje.

Ilaçi i Tetë

O i sëmure që mendon për Ahiretin! Sëmundja, ashtu si efekti i sapunit, pastron e heq papastërtitë e tua, fshin gjynahet e tua dhe të pastron nga mëkatet.

Vërtetohet nga një hadith i saktë se sëmundjet janë shlyerje për mëkatet. Dhe në një hadith tjetër thuhet:

Ashtu siç bien frutat e pjekura nga pema e tyre kur ajo shkundet, po ashtu bien mëkatet e besimtarit kur ai shkundet me sëmundje.

Gjynahet janë sëmundje kronike të përhershme, në jetën e amshuar dhe në jetën e kësaj bote; ato janë sëmundje për zemrën, për ndërgjegjien dhe për shpirtin. Në qoftë se je i duruar dhe nuk ankoresh, atëherë ti do ta shpëtoje veten tënde nëpërmjet kësaj sëmundje të përkohshme prej sëmundjeve të shumta të përhershme. Në qoftë se ti nuk

mendon për gjynahet e tua, ose e harron Ahiretin, ose nuk e njeh Krijuesin tënd, atëherë unë të them me siguri se ti do të vuash nga një sëmundje shumë e rëndë e cila është një milion herë më e keqe se sa këto sëmundjet e tua të tanishme, kështu ik prej asaj dhe bërtit..! Sepse zemra jote, shpirti yt dhe nefsi yt të gjithë janë të lidhur me të gjitha qëniet e dynjasë. Ato lidhje këputen në mënyrë të vazhdueshme nga vdekja dhe nga ndarja, duke hapur tek ty plagë të panumërta të thella. Veçanërisht, meqenëse ti nuk e njeh Ahiretin dhe e imagjinon vdekjen të jetë një mosekzistencë e përjetshme, atëherë mjaft thjesht sikur i shqyer e i lënduar, qenia jote vuan sëmundje me madhësinë e dynjasë.

Kështu, gjëja e parë që ti duhet të bësh është të kërkosh ilaçin e plotë dhe shërimin e vërtetë për qënien tënde të madhe jolëndore të cilën e shqyejnë dhe e copëtojnë sëmundjet e pakufishme dhe lëngatat e pamunërta; unë mendoj se do ta gjesësh veçse në ilaçin e besimit dhe në balsamin e tij kurues. Dhe mësoje se arritja për tek ai ilaç është të shikosh nëpërmjet dy dritareve të pafuqisë dhe të varfërisë të cilat hapen me anë të sëmundjes tënde fizike e cila gris perden e pakujdesisë dhe të cilat janë në natyrën e njeriut, dhe si rrjedhojë të arrish tek njohja e fuqisë së të

Gjithëfuqishmit të Gjithëlavdishëm dhe tek mëshira e Tij e gjërë.

Po, ai që nuk e njeh Allahun mban mbi kokën e tij shqetësime e fatkeqësi sa gjërësia e dynjasë me çfarë përmban ajo; kurse ai i cili e njeh Krijuesin e vet, bota e tij mbushet me dritë e me kënaqësi shpirtërore; ai i percepton këto sipas fuqisë së besimit të tij. Po, dhimbja e sëmundjeve të pjesshme fizike shkrihet e largohet nga gëzimi shpirtëror; nga kurimi e kënaqësia që burojnë nga ky besim; dhe vuajtja bie e tretet.

Ilaçi i Nëntë

O i sëmurë që beson në Krijuesin tënd! Dhimbja, frika dhe ankthi në sëmundje është për shkak se sëmundja ndonjëherë çon në vdekje e shkatërrim. Meqenëse vdekja, me shikimin e pakujdesisë është e frikshme dhe e trishtueshme në anë të jashtme, sëmundjet që mund të jenë shkak për të çojnë në shqetësim e në tronditje. Atëherë dije:

Së Pari: Beso me siguri se Exheli, çasti i fundit i jetës, është i paracaktuar dhe nuk ndryshon. Ka ndodhur që kanë vdekur ata që qajnë pranë të sëmurëve rëndë ndonëse gëzonin shëndet të mirë, dhe janë shëruar ata që ishin të sëmurë rëndë dhe pasaj kanë jetuar mirë.

Së Dytë: Vdekja, në vetvete, nuk është e tmerrshme, ashtu siç na duket në formën e saj të jashtme. Ne e kemi provuar në shumë pjesë të Risale-i Nurit dhe në mënyrë të pakundërshtueshme nëpërmjet dritës së dhënë nga Kur'ani:

- Se për besimtarët vdekja është një shkarkim nga detyrat e rënda të jetës.

- Për ta ajo është një pushim, lirim, nga adhurimi, i cili është instruksion e stërvitje në arenën e sprovës së kësaj bote.

- Ajo është dera e bashkimit për t'u takuar me nëntëdhjetë e nëntë përqind të të dashurve dhe miqve që tashme kanë udhëtuar për në botën tjetër..

- Është një mjet për të hyrë në atdheun e tyre të vërtetë dhe në vendbanimin e lumturisë së përjetshme..

- Ajo gjithashtu është një ftesë për të kaluar nga burgu i dynjasë për tek kopshtet e pemishtet e Parajsës..

- Ajo është koha për të marrë shpërblimin e tyre nga thesari i mirësisë së Krijuesit Mëshirëplotë kundrejt shërbimit që i është bërë Atij.

Meqenëse realiteti i vdekjes është ky, atëherë ajo nuk duhet të shikohet si e tmerrshme, përkundrazi, ajo duhet të

konsiderohet si lajm i gëzueshëm e sihariq i mëshirës dhe i lumturisë.

Për më tepër, disa nga njerëzit e takvasë, e frikës ndaj Allahut, nuk e kishin frikë vdekjen për shkak të vetmisë dhe të tmerrit të saj, por për shkak të dëshirës së tyre që të fitonin më shumë nga veprat e mira nëpërmjet vazhdimësisë së detyrës së jetës.

Po, vdekja për njerëzit e besimit është dera e mëshirës. Ndërsa për njerëzit e çudhëzimit është pusi i një errësire të përhershme.

Ilaçi i Dhjetë

O i sëmure i shqetësuar pa qenë nevoja! Ti shqetësohesh për gjendjen e rëndë të sëmundjes tënde dhe ky shqetësim e shton mbi ty peshën e sëmundjes. Në qoftë se dëshiron që sëmundja jotë të jetë më pak e rëndë, përpiqu të mos shqetësohesh. Domethënë, mendo për dobritë e sëmundjes tënde, për shpërblimin që vjen nga ajo, dhe se ajo do të kalojë shpejt.

Atëherë, shkuli rrënjët e shqetësimit nga vetja jote që sëmundja të shkulet prej rrënjëve.

Po, shqetësimi, ose vesvesja, e shton dy herë më shumë sëmundjen. Shqetësimi i shkakton një sëmundje jolëndore zemrës nën sëmundjen fizike; sëmundja fizike vazhdon

duke u mbështetur tek ajo. Në qoftë se ti i largon prej teje shqetësimin dhe mendimet për të duke iu nënshtruar urdhërit të Allahut, xh.sh., dhe kënaqësisë ndaj vendimit të Tij dhe duke menduar rreth urtësisë në sëmundje, atëherë një pjesë e rëndësishme e sëmundjes tënde fizike do të shkulet nga rrënjët; ajo do të bëhet më e lehtë dhe pjesërisht zhduket. Ndonjëherë një sëmundje e pjesshme fizike shtohet dhjetëfish vetëm duke menduar nëpërmjet shqetësimit dhe ankthit për të. Shqetësimi e shton sëmundjen. Gjithashtu shqetësimi e bën të sëmurin sikur ai të akuzonte urtësinë Hyjnore, të kritikonte mëshirën Hyjnore dhe të shfaqte ankesë ndaj Krijuesit të tij Mëshirëplotë. Për këtë arsye, në kundërshtim me qëllimet e tij, i sëmuri merr goditje disiplinuese, gjë e cila ia shton sëmundjen e tij. Po, ashtu si falënderimet që shtojnë mirësinë, po ashtu ankesat shtojnë sëmundjen dhe fatkeqësinë.

Për më tepër, shqetësimi në vetvete është një sëmundje. Ilaçi për të është vetëm të njohësh urtësinë në sëmundje.

Meqenëse ti i ke mësuar qëllimin dhe dobinë e saj, atëherë fshije shqetësimin tënd me atë balsam dhe gjej lehtësim e shpëtim. Dhe në vend të rënkimit dhe ofshamave “Oh,

medet”, thuaj: El Hamdu lil-lah ala kul-li hal, Lavdi Allahut për çdo gjendje.

Ilaçi i Njëmbëdhjetë

O vëllai im i sëmurë i paduruar! Megjithëse sëmundja të shkakton ty një dhimbje të menjëhershme, në të njëjtën kohë zhdukja e sëmundjes tënde të kaluar i jep një kënaqësi shpirtërore dhe një lumturi shpirtit që buron nga shpërblimi i marrë nga përballimi i saj me durim.

Atëherë, koha e ardhme pas të sotmes, madje pas kësaj ore, nuk ka sëmundje. Dhe sigurisht asnjë sëmundje nuk mund të jetë nga asgjëja, dhe në qoftë se nuk ka dhimbje, atëherë nuk mund të ketë asnjë brengë apo lëngatë. Por meqenëse ti i imagjinon gjërat në mënyrë të gabuar, dëshpërimi e shqetësimi të bien ty, sepse me zhdukjen e periudhës së sëmundjes fizike është shkrirë edhe dhimbja e asaj periudhe gjithashtu; vetëm shpërblimi i saj dhe kënaqësia e kalimit të saj mbetet. Do të ishte marrëzi të kujtosh pas kohës së tanishme sëmundjen e kaluar e të ndjehesh i dëshpëruar dhe të humbasësh durimin në një kohë që kjo duhet të të japë ty lehtësim e qetësi për shkak të shpërblimit që vjen nga ajo dhe që ka kaluar. Sa për ditët e ardhshme, ato nuk kanë ardhur akoma. Do të ishte çmenduri

ta preokuposh veten qysh tani duke menduar për një ditë e cila nuk ka ardhur akoma, për një sëmundje e cila nuk ka rënë akoma dhe për një dhimbje që nuk ka ndodhur akoma; ky lloj imagjinimi si rezultat i mendimit që tregon shqetësim, dhe i rëndimit të vetvetes me një dhimbje të rëndë, kjo çon në humbjen e durimit dhe u jep ngjyrën e ekzistencës tre shkallëve të mosekzistencës; a nuk është marrëzi kjo? Meqenëse kohët e sëmundjes të cilat i kanë paraprirë kësaj ore ngjallin gëzim, dhe meqenëse koha e ardhshme pas kësaj ore është mosekzistuese, edhe sëmundja është mosekzistuese, edhe dhimbja është mosekzistuese.

O vëlla! Mos e shpërndaj fuqinë e durimit, e cila të është dhënë ty nga Allahu i Plotëfuqishëm në të djathtën e në të majtën, por grumbulloje e përqëndroje atë përballë dhimbjes së orës së tanishme; dhe thuaj: !Ja Sabur, O më i Duruari! dhe bëji ballë asaj.

Ilaçi i Dymbëdhjetë

O njeri i sëmurë që për shkak të sëmundjes nuk mund ta kryesh adhurimin dhe nuk mund t'i bësh virdet, tesbihatet dhe duatë dhe që ndjehesh i dëshpëruar për shkak të këtij privimi! Dije se është pohuar në një hadith profetik se,

“Besimtarit të devotshëm i vjen thevabi i ibadetit, të cilin ai e kryente rregullisht, edhe gjatë sëmundjes së tij; sëmundja nuk e pengon thevabin -shpërblimin.”

I sëmuri që i kryen farzet me sa të ketë mundësi me durim e duke u mbështetur tek Allahu, xh.sh., gjatë asaj sëmundjeje të rëndë, sëmundja merr vendin e sunneteve të tjera dhe në një formë të singertë.

Për më tepër, sëmundja e bën njeriun të kuptojë pafuqinë dhe dobësinë e tij. Ajo i shkakton atij të bëjë dua edhe me gojë edhe nëpërmjet gjuhës së pafuqisë dhe të dobësisë së tij. Allahu i Plotëfuqishëm i dhuroi njeriut një pafuqi të pakufishme dhe një dobësi të pafundme me qëllim që ai në mënyrë të vazhdueshme të kërkojë strehim tek prania Hyjnore dhe t'i lutet e t'i përgjërohet duke shpresuar.

Në përputhje me kuptimin e vërsetit,

قُلْ مَا يَعْبُؤُا بِكُمْ رَبِّي لَوْلَا دُعَاؤُكُمْ

“Thuaju (o Muhammed): “Allahu im kujdeset për ju vetëm nga dua ja juaj drejtuar Atij.”⁵

Domethënë, çfarë rëndësie do të kishit ju në goftë se nuk do të bënit dua? Urtësia në

⁵ Kur'an, 25: 77

krijimin e njeriut dhe arsyeja për vlerën e tij është duaja e sinqertë. Meqenëse një shkak i kësaj duaje të sinqertë është sëmundja, nga ky këndvështrim nuk duhet të ankohesh për të, por duhet të bësh falënderime për të, sepse nuk duhet të thahen burimet e duasë të cilat i shpërthen sëmundja nëpërmjet fitimit të shëndetit.

Ilaçi i Trembëdhjetë

O i sëmurë që ankohesh nga sëmundja! Për disa njerëz sëmundja është një thesar i rëndësishëm dhe një dhuratë e çmueshme Hyjnore për ta. Çdo njeri i sëmurë mund ta përfytyrojë sëmundjen e tij prej këtij lloji, me qëllim që ta shpëtojë njeriun nga dëshpërimi dhe nga pakujdesia absolute dhe për ta mbajtur atë midis shpresës dhe frikës dhe kështu për të ruajtur edhe dynjanë edhe Ahiretin e tij; në urtësinë e Tij Allahu i Plotëfuqishëm e ka fshehur çastin e Exhelit. Exheli mund të vijë në çdo kohë; në qoftë se ai e kap njeriun në pakujdesi, kjo mund t'i shkaktojë dëm të rëndë jetës së tij të përhershme. Ndërsa sëmundja e largon pakujdesinë, ajo e bën njeriun të mendojë për Ahiretin; ajo i kujton vdekjen, dhe kështu ai mund të përgatitet. Disa sëmundje janë aq të dobishme saqë ato mund ta bëjnë njeriun të

fitojë për njëzet ditë një rang i cili mund të arrihet për njëzet vite.

Për shembull, midis shokëve të mi ishin dy të rinj, Allahu i mëshiroftë. Njëri ishte Sabriu nga fshati Ilema, ndërsa tjetri Mustafa Vezirzade prej Islamköy. Unë vëreja me habi se, megjithëse këta të dy nuk mund të shkruanin, mirëpo ata ishin në rreshtin e parë në besnikëri e sigëritet në shërbim të imanit; unë nuk e kuptova arsyen për këtë në atë moment. Pas vdekjes së tyre kuptova se të dy ata kishin vuajtur nga një sëmundje e rëndë. Nëpërmjet udhëzimit të asaj sëmundjeje, jo si të rinjtë e tjerë neglizhentë të cilët kishin braktisur adhurimin e tyre të detyruar, ata të dy kishin takva (frikën ndaj Allahut), kishin kryer një shërbim shumë të çmueshëm dhe kishin arritur një gjendje të dobishme për Ahiretin. Unë i lutem Allahut, xh.sh., që dëshpërimi i sëmundjes prej dy viteve të jetë mjeti për lumturinë e miliona viteve të jetës së përhershme. Unë tani e kuptoj se lutjet që unë kisha bërë për shërimin e tyre, ishin nëmë nga këndvështrimi i dynjasë, por shpresoj që Allahu ta pranojë lutjen time për mirëqënien e tyre në Ahiret.

Kështu, sipas besimit tim, këta dy të rinj arritën një fitim të barabartë me fitimin të cilin

e arrin njeriu me përpjekje e devocion të paktën për dhjetë vite.

Në qoftë se këta dy të rinj, ashtu si disa të tjerë, do të ishin mbështetur në rininë e tyre dhe në shëndetin e mirë dhe do ta kishin hedhur vetveten në pakujdesi e shthurje derisa t'u vinte vdekja që i përgjon, do t'i rrëmbente mu në papastërtinë e mëkateve të tyre; ata do t'i bënë varret e tyre strofa akrepash e gjarpërinjsh, në vend të thesareve të dritave.

Meqenëse sëmundja përmban dobi të tilla, nuk duhet të ankohesh prej saj, por duhet të mbështetesh tek mëshira Hyjnore me besim e durim dhe madje duke e falënderuar Allahun, xh.sh., dhe duke pasur besim në mëshirën e Tij.

Ilaçi i Katërmëdhjetë

O i sëmurë që sytë e tu kanë zhvilluar perde katarakt! Në qoftë se do ta dije se çfarë drite dhe çfarë syri shpirtëror gjendet poshtë asaj perdeje që ka mbuluar sytë e besimtarëve, ti do të thojë:

“Një mijë e një falënderime qofshin për Krijuesin tim Fuqiplotë”.

Unë do të përmend një ngjarje për ju me qëllim që të shpjegoj këtë balsam. Ai është si më poshtë vijon:

Një herë, halla e Sulejmanit nga Barla, i cili më ka shërbyer tetë vite me besnikëri të plotë me gatishmëri e respekt, u godit me verbërim, dhe u shua drita e syrit të saj. Duke pasur mendim të mirë për mua, duke menduar mirë për mua njëqind herë më shumë se sa unë e meritoj, gruaja e drejtë më ndaloi tek dera e xhamisë kur unë po dilja, duke më thënë: “Për hatrin e Allahut bëj dua Allahut që të më vijë shikimi. Dhe unë e bëra drejtësinë e asaj gruaje të bekuar besimtare ndërmjetësuesen për duanë time dhe duke iu përgjëruar Allahut të Plotëfuqishëm, unë u luta:

“O Allah! O Krijuesi ynë! Për hir të drejtësisë së saj ktheja prapë shikimin!” Pas dy ditësh erdhi një okulist nga krahina e Burdurit, ia hoqi perden dhe Allahu ia ktheu shikimin. Pas dyzet ditësh ajo e humbi përsëri shikimin e saj. Unë u shqetësova shumë dhe u luta me pasion të fortë për të, se në dashtë Allahu lutja të pranohej për jetën e saj në Ahiret, ose ndryshe duaja ime për të do të kishte qenë gabimisht një nëmë për të. Ajo qëndroi për dyzet ditë deri në vdekjen e saj; pas dyzet ditësh ajo kishte vdekur, Allahu i dhëntë mëshirë.

Kështu, privimi i kësaj gruaje, për të cilën shpresohet mëshira, nga mirësia e shikimit, duke i parë me pikëllim kopshtet e Barlës me

syryn e moshës së vjetër, iu kompensua me përfitimin në varrin e saj duke qenë e aftë të shikojë për dyzet mijë ditë në kopshtet e Parajsës, sepse besimi i saj ishte i fortë dhe drejtësia e saj ishte shumë e madhe.

Po, në qoftë se një besimtar humbet shikimin e tij dhe hyn i verbër në varr, ai mundet ta shikojë botën e dritës, sipas shkallës së tij, me një shikim më të gjërë prej shikimit të të tjerëve në varrezat e tyre; sepse ashtu siç shohim ne shumicën e gjërave në këtë dynja, të cilat besimtarët e verbër nuk mund t'i shohin, edhe në varr gjithashtu, ata njerëz të verbër, në qoftë se kanë kaluar me iman, do të shohin me atë shkallë më shumë se sa të vdekurit e tjerë në varret e tyre. Ashtu sikur të shihnim nëpërmjet teleskopëve më të fuqishëm, ata mund të shikojnë e të sodisin kopshtet e parajsës si ekran kinemaje, në përputhje me shkallët e tyre.

Kështu, me falënderime e durim ju mund të gjeni poshtë perdes së syrit tuaj të tanishëm një sy i cili është i mbushur kaq me dritë dhe me të cilin ndërsa je nën tokë ti mund të shikosh e të sodisësh parajsën mbi qiej. Ajo që do ta heqë perden nga syri yt, doktori i syrit i cili do të të lejojë ty të shikosh me atë sy, është Kur'ani i gjithurtë.

Ilaçi i Pesëmbëdhjetë

O i sëmure që psherëtin e vajton! Mos shiko aspektin e jashtëm të sëmundjes dhe tek rënkimi, por shiko tek kuptimi i saj dhe ji i kënaqur. Në qoftë se kuptimi i sëmundjes nuk do të kishte qenë i mirë, Krijuesi Mëshirëplotë nuk do t'u kishte dhënë sëmundje shërbëtorëve të Tij, të cilët Ai i do shumë. Ndodhet një hadith, kuptimi i të cilit është ky:

أَشَدُّ النَّاسِ بَلَاءً الْإِنْبِيَاءُ ثُمَّ الْأَوْلِيَاءُ الْأَمْثَلُ فَلَا مِثْلَ

“Njerëzit që sprovohen me fatkeqësitë më të rënda janë profetët, pastaj Evlijatë dhe pastaj ata që u ngajnë më shumë atyre”.⁶

Domethënë, ata që sprovohen me fatkeqësi e vështirësi janë më të mirët e njerëzimit, më të plotët. Ose, ashtu siç tha:

Në krye të atyre që janë sprovuar qëndron profeti i duruar Ejubi a.s., pastaj profetët e tjerë, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ta, pastaj Evlijatë, shenjtorët, dhe pastaj të drejtët. Të gjithë ata i vlerësuan sëmundjet që u ranë si adhurim i singertë, si dhurata të të Gjithëmëshirshmit dhe dhanë falënderime nëpërmjet durimit.

Gjithashtu ata i shikonin ato si operacione kirurgjikale që kryheshin nga ana e të

⁶ Transmeton Hakimi

Gjithëmëshirshmit Mëshirëplotë. O i sëmurë që rënkon e vajton! Në qoftë se dëshiron t'i bashkohesh këtij karvani të ndritshëm, jep falënderime me durim. Në qoftë se ti ankohesh, ata nuk do të të pranojnë ty, dhe ti do të biesh në gropat e në kurthet e njerëzve të çudhëzimit dhe do të udhëtosh në rrugë të errët.

Po, ndodhen disa sëmundje të cilat në qoftë se çojnë në vdekje, janë si një lloj martirizimi; ato rezultojnë në një shkallë të shenjtërisë si martirizim.

Për shembull, ata që vdesin nga sëmundjet duke lindur fëmijën,⁷ që shoqëron lindjen e fëmijës, nga dhimbjet e barkut, nga mbytja, djegia dhe nga flama (murrtaja), arrijnë gradën e një martiri në kuptim.

Gjithashtu ka shumë sëmundje të bekuara nëpërmjet të cilave njerëzit fitojnë shkallën e shenjtërisë kur vdesin prej tyre. Për më tepër, meqenëse sëmundja e pakëson dashurinë për dynjanë dhe lidhjen e fortë me të, ajo e lehtëson ndarjen nga dynjaja nëpërmjet vdekjes, gjë e cila për njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje është shumë e hidhur e

⁷ Periudha që mund të fitohet ky martirizim është rreth dyzet ditë prej kohës së lindjes.

pikëlluese, dhe madje ajo ndonjëherë e bën atë të dëshirueshme për ta.

Ilaçi i Gjashtëmbëdhjetë

O i sëmure që ankohesh nga pikëllimi yt! Sëmundja ngjall respekt e dashuri të cilat janë shumë të rëndësishme e të mira në jetën shoqërore humane, sepse ajo e shpëton njeriun nga vetëmjaftueshmëria, pa ua pasur nevojën të tjerëve, gjë e cila të shtyn për në pashoqërueshmëri, në egërsi në sjellje me shokët, dhe e zhvesh njeriun nga mëshira; sepse sipas kuptimit të:

اِنَّ الْاِنْسَانَ لِرَبِّهِٖ لَكٰٔفٍۭۤۤۤ اٰسِٔءٌۭۤۤۤ
اَنْ رَّآهُ اسْتَغْنٰی

“Por ja, njeriu i kalon të gjithë kufijtë, ngaqë e sheh veten të vetëmjaftueshëm.”⁸

Nefsi urdhërues për të liga i cili ndjehet i vetëmjaftueshëm për shkak të shëndetit të mirë dhe të mirëqënies, nuk ndien respekt ndaj vëllezërve të tij në shumë drejtime të cilët janë të meritueshëm për të, dhe ai nuk ndien dashuri e dhembshuri për të sprovuarit me sëmundje e fatkeqësi, ndonëse ato meritojnë mirësi e mëshirë. Por sa herë që sëmuret, ai e kupton pafuqinë dhe varfërinë e tij dhe ndien respekt për vëllezërit e tij të cilët janë të denjë

⁸ Kur'an, 96: 6-7

për të. Ai ndien respekt ndaj vëllezërve të tij besimtarë të cilët e vizitojnë ose e ndihmojnë atë. Dhe ai ndien një dashamirësi humane të që burojnë nga mirëkuptimi e simpatia, dhe dhembshuri për ata që janë goditur nga fatkeqësia, e cila është veçoria islamike më e rëndësishme atyre që janë goditur. Dhe duke i krahasuar ata me vetveten, ai ndien keqardhje e simpati për ta në kuptimin e vërtetë të fjalës dhe ndien dhembshuri për ta. Ai bën çfarë të mundet për t'u ardhur atyre në ndihmë dhe, në qoftë se nuk ka mundësi, ai të paktën bën dua për ta, shkon t'i vizitojë për t'i pyetur si janë, gjë e cila është sunnet profetik në përputhje me sheriatin dhe kështu fiton një thevab të madh.

Ilaçi i Shtatëmbëdhjetë

O i sëmure që ankohesh nga pafuqia për të kryer vepra të mira për shkak të sëmundjes! Ji mirënjohës! Po të jap sihariqin se është sëmundja ajo që të hap derën e veprave të mira më të singerta. Sëmundja, përveç se e bën njeriun e sëmure që të fitojë thevab në mënyrë të vazhdueshme dhe për ata që kujdesen për të për hir të Allahut, xh.sh., ajo është mjeti më i rëndësishëm për pranimin e duasë.

Po, ka një shpërblim të madh për besimtarët që kujdesen për të sëmurët. Të interesuarit për shëndetin dhe shkuarja për vizitë tek i sëmuri, me kusht që të mos e lodhësh e ta shqetësosh, është sunnet dhe njëkohësisht shlyerje për gjynahet. Ndodhet një hadith i cili thotë:

“Kërkoni dua nga të sëmurët sepse duatë e tyre janë të pranuar”.⁹

Në mënyrë të veçantë, në qoftë se i sëmuri është nga të afërmit dhe sidomos kur është baba ose nënë, të kujdesesh për ata është një ibadet i rëndësishëm dhe një thevab shumë i madh gjithashtu. Të gëzosh zemrën e një personi dhe ta ngushëllosh atë, konsiderohet si një lëmoshë e rëndësishme. Sa fatlumë janë ata fëmijë që kujdesen për baballarët e për nënat e tyre kur ata janë të sëmurë dhe fusin gëzimin në zemrat e tyre të holla e të pjekura dhe fitojnë duanë e prindërve të tyre.

Po, realiteti që meriton respekt më të madh dhe vend më të lartë në jetën shoqërore është dhembshuria e dy prindërve dhe përgjigja e fëmijëve të tyre ndaj asaj dhembshurie, dhe duke shfaqur respektin e plotë dhe dashamirësinë bijërore ndaj atyre të dyve kur ata vuajnë nga sëmundja. Kjo është një tablo

⁹ Transmeton Ibn Maxheh

në të cilën shfaqet qëndrimi i mirë i fëmijëve dhe lartësia e humanizmit saqë shkakton admirimin e habinë e të gjitha krijesave dhe madje dhe të melekëve. Ata i përshëndesin duke i thënë La ilahe il-lallah, Allahu Ekber dhe i brohorasin duke thënë Mashallah, Barekallah.

Po, ka kënaqësi në kohën e sëmundjes të cilat burojnë nga dashamirësia, dhembshuria dhe mëshira e atyre që janë përreth të sëmurit; ato i shkrijnë dhe i pakësojnë dhimbjet e sëmundjes dhe e transformojnë në diçka shumë të kënaqshme e të këndshme. Pranueshmëria e duasë së të sëmurit dhe përgjigjja ndaj saj është një çështje shumë e rëndësishme që meriton t'i kushtohet vëmendje.

Për tridhjetë apo dyzet vitet e kaluara, unë vetë jam lutur për t'u shëruar nga një sëmundje në shpinën time nga e cila kam vuajtur. Pastaj kuptova se sëmundja ishte dhënë për hir të duasë.

Dhe meqenëse duaja nuk e largon duanë, domethënë, duaja nuk mund ta largojë vetveten, atëherë unë kuptova se rezultatet e duasë i përkasin Ahiretit¹⁰, dhe se ajo në

¹⁰ Po, disa sëmundje janë shkak për ekzistencën e lutjes; në qoftë se lutja është shkak i mosekzisencës së

vetvete është një lloj adhurimi sepse nëpërmjet sëmundjes, njeriu kupton pafuqinë e tij dhe kërkon strehim tek prania Hyjnore.

Prandaj, megjithëse për tridhjet vite unë kam bërë dua për t'u shëruar dhe në dukje duaja ime nuk u pranua, prapëseprapë nuk e pashë të arsyeshme ta braktisja duanë, sepse sëmundja është koha e duasë, ndërsa shërimi nuk është rezultati i duasë. Në qoftë se Allahu, xh.sh., i Cili është i Gjithurti Mëshirëplotë, jep shërimin, Ai e jep atë nga mirësia dhe nga bujaria e Tij.

Për më tepër, në qoftë se duatë nuk pranohen në formën që ne e dëshirojmë, nuk mund të thuhet se ato nuk janë pranuar. Krijuesi i Gjithurtë e di më mirë se sa ne, kurse ne nuk e dimë; Ai na shtyn ne për tek ajo, që është më e mirë dhe më e dobishme për ne; Ai ndonjëherë i ruan, i depoziton duatë tona të posaçme për dynjanë tonë me qëllim që të na vlejné ne në Ahiretin tonë, dhe në këtë mënyrë i pranon duatë. Sidoqoftë një dua e cila fiton singëritet për shkak të sëmundjes dhe që buron nga dobësia, pafuqia, përlulesia, nënshtrimi dhe nga nevoja, është shumë e

sëmundjes, atëherë ekzistenca e lutjes do të ishte shkaku i mosekzistencës së vetvetes, dhe kjo nuk do të ishte e mundur. Autori.

afërt për t'u pranuar. Sëmundja është themeli i një duaje të tillë të singertë dhe boshti i saj.

Atëherë ashtu si të sëmurët që janë besimtarë, po ashtu edhe besimtarët që kujdesen pës të sëmurëve, duhet të përfitojnë nga kjo lutje.

Ilaçi i Tetëmbëdhjetë

O i sëmurë që ke lënë dhënien e falënderimeve dhe që ke marrë ankesat! Ankesa buron nga një e drejtë. Asnjë nga të drejtat e tua nuk është humbur saqë ti ankohesh. Madje ka shumë të drejta për të cilat ti nuk ke dhënë akoma falënderime që janë obligim për ty. Ti nuk e ke përmbushur të drejtën e Allahut mbi ty. Pa i dhënë të drejtën Krijuesit, ti po ankohesh sikur të kërkoje të drejtat në një mënyrë që nuk është e drejtë. Ti nuk ke të drejtë të ankohesh kur i sheh të tjerët që janë në një shkallë më të lartë se sa ti lidhur me shëndetin, por ty të duhet, nga këndvështrimi i shëndetit t'i shikosh ata të pafuqishëm të sëmurë që janë në shkallë më të ulët se sa ty.

Atëherë ti je i urdhëruar për të dhënë shumë falënderime. Në qoftë se dora jote është thyer, shiko duart e atyre që janë këputur. Në qoftë se ti ke vetëm një sy, shiko

ata të verbër të cilëve u mungojnë të dy sytë. Dhe jepi falënderime Allahut, xh.sh.!

Sigurisht, asnjë nuk ka të drejtë nga këndvështrimi i mirësive që të drejtojnë shikimin tek ata që janë sipër tyre dhe si rrjedhojë të ankohen. Ndërsa në fatkeqësi njeriu ka të drejtë, nga këndvështrimi i fatkeqësisë, të shikojë tek fatkeqësitë dhe sëmundjet e atyre që janë më të rënda me qëllim që ata të japin falënderime. Ky mister është shpjeguar në disa pjesë të Risale-i Nurit me një krahasim; një përmbledhje e tij është sa vijon:

Një person merr për dore një njeri të mjerë për ta ngjitur në majë të minares. Në çdo shkelëz të shkallëve të minares, ai i jep atij një dhuratë të ndryshme, një mirësi të ndryshme. Mu në majë të minares ai i jep atij dhuratën më të madhe.

Megjithëse kërkohej medoemos që njeriu i mjerë të jepte falënderime e mirënjohje kundrejt dhuratave të shumëllojshme, ti e sheh atë t'i harrojë të gjitha dhuratat që kishte marrë në çdo shkelëz të shkallëve, ose i vlerëson ato si të parëndësishme dhe duke mos dhënë falënderime, ai i shikon sipër vetes dhe fillon të ankohet duke thënë: "Ah sikur të kishte qenë më e gjatë kjo minare që të mund

të ngjitesha edhe më lart”. Përse ajo nuk është aq e lartë sa mali atje ose sa minaret e tjera?”

Në qoftë se ai fillon të ankohet në këtë mënyrë, sa shumë mosmirënjohje do të ishte kjo dhe sa padrejtësi!

Pikërisht në të njëjtën mënyrë, njeriu i cili erdhi në ekzistencë nga mosekzistenca dhe, nuk u bë as shkëmb, as pemë dhe as kafshë, por u bë një njeri e një musliman dhe në pjesën më të madhe të kohës ai gëzon shëndet të mirë dhe fiton një nivel të lartë mirësish. Pavarësisht të gjithë kësaj, të ankohesh e të shfaqësh padurim për shkak se ai nuk është i denjë për disa mirësi, ose për shkak se ai i humbet ato nëpërmjet zgjedhjes së tij të keqe ose të keqpërdorimit, ose për arsye se ai nuk mund t’i arrijë e t’i fitojë ato, dhe pastaj thotë: “Çfarë kam bërë që kjo më ka rënë mua”, dhe duke kritikuar kështu Hyjninë e Krijuesit, kjo gjendje është një sëmundje shpirtërore më e kobshme se sa sëmundja fizike. Ashtu si të luftuarit me një dorë të thyer, ankesa e bën sëmundjen e tij më të rëndë e më të keqe.

I mençur është ai që në përputhje me kuptimin e vërsetit thotë:

الَّذِينَ إِذَا أَصَابَتْهُمْ مُصِيبَةٌ قَالُوا إِنَّا لِلَّهِ وَإِنَّا إِلَيْهِ
رَاجِعُونَ

“Të cilët thonë kur u bie fatkeqësi: Vërtet që të Allahut jemi dhe padyshim tek Ai do të kthehemi”,¹¹ nënshtrohet dhe është i duruar, me qëllim që sëmundja të mund të përmbushë detyrën e saj dhe atëherë të largohet.

Ilaçi i Nëntëmbëdhjetë

Ashtu si termi i përjetshmërisë prej Emrave më të bukur Hyjnorë që tregon se të gjithë Emrat e bukur të të Gjithëlavdishmit janë të bukur, sepse midis qënieve, pasqyra më e hollë, më e bukur dhe më gjithëpërfshirëse e të Synuarit të Përjetshëm është jeta. Pasqyra e të Bukurit është gjithashtu e bukur. Dhe pasqyra që reflekton Bukuritë e të Bukurit, bëhet gjithashtu e bukur, dhe çdo gjë që e godet atë pasqyrë prej Atij të Bukurit është gjithashtu e bukur. Po ashtu, çdo gjë që i bie jetës nga këndvështrimi i realitetit është e mirë, sepse ajo shfaq skalitjet e bukura të atyre Emrave të bukur Hyjnorë të cilët janë të mirë e të bukur.

Në qoftë se jeta kalon në mënyrë të pandryshueshme, monotone, me shëndet të mirë të përtëritshëm dhe në mirëqenie, ajo do të bëhej një pasqyrë e mangët. Madje, nga një

¹¹ Kur'an, 2: 156

drejtim ajo tregon mosekzistencë, mosqënie e asgjësi dhe shkakton mërzi e mundim. Ajo pakëson vlerën e jetës dhe e transformon kënaqësinë e jetës në dëshpërim. Për shkak se duke menduar se ai do ta kalojë kohën e tij shpejt, nga mëzia njeriu e hedh veten e tij ose në shthurje ose në zbavitje. Ashtu si i burgosuri në burg, ai bëhet armiqësor ndaj jetës së tij të çmueshme dhe dëshiron ta vrasë e ta bëjë të kalojë shpejt.

Ndërsa një jetë që rrotullohet në ndryshueshmëri, në veprime e në gjendje të ndryshme, bën të ndihet vlera e saj. Madje edhe në qoftë se është në mundim e fatkeqësi, një njeri i tillë nuk dëshiron që ta kalojë shpejt jetën e tij. Ai nuk ankohet nga mërzia, duke thënë: “Ah, sa keq! Dielli nuk ka përënduar akoma” ose “është akoma natë”.

Po, nëse dëshiron, pyete një njeri të pasur e dembel dhe që jeton në mes të të gjitha të mirave, dhe i thuaj: “Si je?” Ti do të dëgjoje prej tij përgjigje prekëse e për të të ardhur keq, si: “Ah kjo kohë, ajo nuk po kalon... eja të bëjmë një tavllë -lojë- ose le të gjejmë ndonjë zbavitje për të kaluar kohën.” Ose ndryshe ti do të dëgjosh ankesa që burojnë nga ambiciet e kësaj bote, si, “unë kam lënë të mangët filan punë, ah sikur ta kisha bërë kështu apo ashtu”.

Ndërsa në qoftë se do të pyesje një njeri të goditur nga fatkeqësia ose një punonjës, ose një njeri të varfër që jeton në vështirësi e mundim, e t'i thojë: "Si je? Si e ke hallin?" në qoftë se ai do të ishte i ndjeshëm, do të përgjigjej: "Lavdi Allahut dhe të gjitha falënderimet i takojnë Krijuesit tim, unë jam mirë e po punoj. Në qoftë se mbrëmja nuk do të kishte ardhur kaq shpejt, unë do ta kisha mbaruar këtë punë! Koha kalon shumë shpejt, edhe jeta gjithashtu; ato kalojnë shumë shpejt. Sigurisht gjërat janë të vështira për mua, por edhe kjo gjithashtu do të kalojë. Çdo gjë kalon shpejt". Ai me këto fjalë shpreh vlerën e jetës dhe rëndësinë e saj brenda dëshpërimit e keqardhjes së tij për jetën e cila ikën. Kjo do të thotë se ai e kupton kënaqësinë dhe vlerën e jetës nëpërmjet mundimit dhe punës.

Ndërsa, rehatia, lehtësia dhe shëndeti i mirë e bëjnë jetën të hidhur dhe e rëndojnë sa që e bëjnë njeriun të dëshirojë që ajo të kalojë.

O vëllai im i sëmurë! Dije se origjina dhe fara e të gjitha fatkeqësive, e të këqijave dhe madje e të gjitha gjynaheve është mosekzistenca, ashtu siç është provuar në mënyrë vendimtare dhe në detaje në pjesët e tjera të Risale-i Nurit. Sa për mosekzistencën, ajo është thjesht e keqe dhe errësirë e plotë. Për shkak se gjendjet monotone të

pandryshueshme, si, rehatia, heshtja, qetësia, ndalimi e ndërprerja janë të afërta me mosekzistencën dhe asgjësinë, ato bëjnë të ndjehet errësira e mosekzistencës dhe shkaktojnë dëshpërim. Sa për veprimin dhe ndryshimin, ato janë ekzistencë dhe e bëjnë ekzistencën të ndjehet. Ekzistenca është thjesht e mirë e pastër; ajo është dritë.

Meqenëse realiteti është ky, sëmundja jote i është dërguar qënies tënde si një mysafir për të kryer shumë detyra si pastrimi i jetës tënde të çmueshme, për ta përforcuar, për ta bërë të përparojë dhe për t'i bërë aftësitë e tjera humane në trupin tënd të drejtohen për t'i ardhur në ndihmë gjymtyrës tënde të sëmurë dhe për të shfaqur qëndisjet e Emrave të Krijuesit të Gjithurtë. Në dashtë Allahu, xh.sh., ajo do t'i përmbushë detyrat e saj shpejt dhe do të largohet. Dhe ajo do t'i thotë shëndetit të mirë: "Hajde dhe qëndro përgjithmonë në vendin tim dhe zbato detyrat e tua. Kjo shtëpi është e jotja. Qëndro këtu në shëndet të mirë".

Ilaçi i Njëzetë

O i sëmurë që kërkon një ilaç për sëmundjen tënde! Dije se sëmundja është dy llojesh: Një lloj është real, tjetri imagjinar. Sa për llojin real, Shëruesi i Gjithurtë i

Gjithëlavdishëm ka bërë për çdo sëmundje ilaç, dhe i ka depozituar në farmacinë e Tij më të madhe e cila është toka. Ato sëmundje kërkojnë ilaçe. Krijuesi, xh.sh., ka krijuar ilaçe për çdo sëmundje. Prandaj marrja e ilaçeve dhe përdorimi i tyre për qëllim mjekimi janë të ligjshme nga sheriat. Por njeriu duhet ta dijë se efekti i ilaçit dhe shërimi janë vetëm nga Allahu i Plotëfuqishëm. Ai ashtu siç jep ilaçin, po ashtu jep edhe shërimin.

Ndjekja e këshillave të doktorëve të aftë muslimanë dhe të rekomandimeve është një ilaç i rëndësishëm, sepse sëmundjet më të shumta burojnë nga keqpërdorimi, nga mungesa e regjimit dietetik, nga harxhimi i tepërt, nga neglizhimi i udhëzimit, nga gjynahet, shthurja dhe nga mungesa e kujdesit. Një doktor fetar sigurisht do të jepte këshilla e porosi brenda limiteve të të lejuarës. Ai do të ndalonte nga keqpërdorimet dhe teprimet dhe do të ngjallte shpresë tek i sëmuri dhe do t'i jepte ngushëllim; kështu sëmundja e tij do të lehtësohej; ai do të shkaktonte lehtësi për të në vend të pikëllimit.

Sa për llojin imagjinar të sëmundjes, ilaçi më i efektshëm për të është të mos i japësh rëndësi asaj. Sa më shumë rëndësi që t'i japësh, aq më shumë ajo rritet e të ënjt. Në qoftë se nuk i jepet rëndësi, ajo pakësohet e

largohet. Sa më shumë të shqetësohen grerëzat, aq më shumë vërshojnë e mizërojnë rreth kokës së njeriut dhe, në qoftë se atyre nuk u jepet rëndësi, ato ikin prej teje e shpërndahen. Gjithashtu, sa më shumë rëndësi që dikush i jep me imagjinatë një cope spangoje që tundet e valëvitet përpara syve të tij në errësirë, aq më shumë do të zmadhohet para tij ajo imagjinatë derisa ta bëjë të ikë prej saj si një i çmendur.

Ndërsa në qoftë se nuk i jep rëndësi, do të zbulohet për të se ajo është thjesht një copë spango dhe jo gjarpër; dhe do të fillonte përqeshjen për shkak të tronditjes së mendjes së tij dhe nga imagjinata.

Gjithashtu kjo sëmundje imagjinare në qoftë se vazhdon shumë, do të transformohet në një sëmundje reale. Ajo është një sëmundje e keqe për nervozët dhe për ata të dhënë pas imagjinatave, ëndrrave; njerëz të tillë e bëjnë qimen tra, dhe shkatërrohen forcat e tyre shpirtërore, në mënyrë të veçantë kur takohen e qëllojnë me doktorë të pamëshirshëm gjysmakë ose me doktorë të padrejtë të cilët i zgjojnë iluzionet e tyre dhe i lëvizin ata më shumë se më parë derisa të humbasin pasurinë e tyre nëse janë të pasur, ose të humbasin mendjet ose shëndetin e tyre.

Ilaçi i Njëzet e Njëte

O vëllai im i sëmure! Në të vërtetë në sëmundjen tënde ndodhet dhimbje fizike, veçse një kënaqësi jolëndore e rëndësishme të rrethon ty dhe do të largojë të gjitha efektet e asaj dhimbjeje fizike; sepse sëmundja jote fizike nuk i kalon atë dhembshuri e mëshirë të kënaqshme të cilat i ke harruar qysh nga fëmijëria dhe të cilat rizgjojnë përsëri tani në zemrat -brendësitë- e dy prindërve të tu dhe të afërmeve të tu drejt teje në qoftë se ti i ke prindërit dhe ke të afërm; pasi ti do t'i shohësh përsëri ato shikime dhe atë dhembshuri të këndshme të cilat ishin kthyer drejt teje në fëmijëri. Dhe zbulohet e hiqet perdja prej të dashurve të tu përreth teje që të kujdesen përsëri për ty dhe të orientohen drejt teje me dashurinë e me dhembshurinë e tyre nëpërmjet tërheqjes së sëmundjes e cila i zgjoi ato ndjenja të brendshme.

Atëherë, sa të lira janë ato dhimbje fizike, nga të cilave ti vuan, përballë atyre shërbimeve të mëdha të kombinuara me mëshirë e dhembshuri nëpërmjet dekretit të sëmundjes që tani po të shërben me dashamirësi dhe u bërë nëpërmjet saj prijës e urdhërues për ta. Për më tepër, meqenëse ti ke tërhequr drejt teje butësinë, simpatinë dhe dhembshurinë humane të njerëzve të cilat

janë të bashkëlindura tek njeriu. Pastaj nëpërmjet kësaj sëmundjes tënde ti ke marrë leje prej shumë detyrave të rënda dhe ke marrë pushim tani.

Atëherë, nuk duhet që të të shtyjë dhimbja jote e pjesshme në ankesë, por në dhënien e falënderimeve përballë këtyre kënaqësive jolëndore.

Ilaçi i Njëzet e Dytë

O vëllai im që vuan nga një sëmundje e rëndë si paraliza - damlla!

Së pari, unë po të jap lajmin e mirë se paraliza konsiderohet e bekuar për besimtarët! Para një kohe të gjatë unë e dëgjoja këtë prej Evlijave të drejtë dhe nuk e dija arsyen. Tani, një arsye për të më shfaqet siç vijon:

Me qëllim që të arrijnë tek i Vërteti, xh.sh., që të shpëtojnë nga rreziqet e mëdhaja shpirtërore të kësaj bote dhe që të fitojnë lumturinë e përjetshme, njerëzit e shenjtërisë kanë zgjedhur për të ndjekur dy parime:

I pari është shqyrtimi i vdekjes. Duke menduar se edhe dynjaja është e përkohshme dhe ata vetë gjithashtu janë mysafirë të përkohshëm të ngarkuar me detyra, ata

punojnë për jetën e përhershme në këtë mënyrë.

I dyti: Nëpërmjet agjërimit, praktikave fetare dhe asketizmit, ata përpiqen ta vrasin neftin urdhërues për të liga dhe kështu të shpëtojnë nga rreziqet e tij dhe nga emocionet e verbëra të cilat nuk i shikojnë pasojat.

O vëllai im që ke humbur shëndetin e gjysmës së trupit tënd! Pa zgjedhjen tënde ty të janë dhënë këto dy parime, të cilat janë të shkurtër, të lehtë dhe ato të shtrojnë rrugën drejt lumturisë tënde të përhershme; ato të kujtojnë ty vazhdimisht natyrën kalimtare të dynjasë dhe se njeriu është i përkohshëm.

Kështu dynjaja nuk mund të të mbysë më, as pakujdesia nuk mund t'i mbyllë sytë e tu. Dhe sigurisht, nefti urdhërues për të liga nuk mund ta mashtrojë me dëshira të ulëta shtazore e me epshe dikë që është në gjendjen e një gjysmë njeriu. Si rrjedhojë, ai shpëton shpejt nga sprovat dhe nga e keqja e neftit.

Kështu, nëpërmjet misterit të besimit në Allah, dhe të nënshtrimit ndaj Tij dhe të mbështetjes tek Ai, besimtari mund të përfitojë në një kohë të shkurtër prej një sëmundjeje të rëndë si paraliza, ashtu si sprovat e Evlijave - shenjtorëve. Atëherë një sëmundje e tillë si ajo bëhet tej mase e lirë.

Ilaçi i Njëzet e Tretë

O i sëmure i mjerë që je i vetëm dhe i huaj dhe i pafuqishëm! Në qoftë se vetmia dhe mërgimi bashkë me sëmundjen tënde bëhen shkas për të ngjallur simpati e dhembshuri ndaj teje në zemrat më të ashpra dhe të tërheqin zemërbutësinë dhe përdëllimin ndaj teje, atëherë si do të ishe lidhur me mëshirën e Krijuesit tënd Mëshirëplotë, manifestimet e mëshirës së të Cilit në çdo pranverë mbushin faqen e tokës, i Cili e prezanton Vetveten para nesh në fillimin e çdo sure Kur'ani me Atributet Er-Rahman, Er-Rahim, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti, dhe që me një shkrepim të mëshirës së Tij i bën të gjitha nënat t'i ushqejnë të vegjlit e tyre me atë zemërbutësi të mrekullueshme, me një manifestim të mëshirës së Tij e mbush faqen e tokës me mirësi në çdo pranverë, dhe nëpërmjet një manifestimi të vetëm të mëshirës së Tij, mishërohet jeta e amshuar në parajsë bashkë me të gjitha bukuritë dhe çudirat e saj.

Atëherë, sigurisht lidhja jote me Atë nëpërmjet besimit dhe të kërkuarit strehim tek Ai nëpërmjet gjuhës së pafuqisë së sëmundjes tënde, shpresa jote prej Tij, përgjërimi duke iu lutur dhe sëmundja jote e vetmisë në mërgim, do të tërheqin vështrimin

e mëshirës së Tij ndaj teje, vështrim i cili merr vendin e gjithçkaje. Meqenëse Ai ekziston dhe të shikon, gjithçka ekziston për ty.

Me të vërtetë, të vetmuar e në mërgim janë ata të cilët nuk janë të lidhur me Të nëpërmjet besimit dhe nënshtrimit, ose që nuk i japin rëndësi asaj lidhjeje.

Ilaçi i Njëzet e Katërt

O ju që kujdeseni për fëmijët e sëmurë të pafajshëm dhe për të moshuarit të cilët janë si fëmijë të pafajshëm! Përpara jush është një tregti e rëndësishme për Ahiretin. Fitojeni atë tregti nëpërmjet zellit dhe përpjekjes së madhe! Është vërtetuar nga njerëzit e realitetit se sëmundjet e fëmijëve të pafajshëm janë si ushtrime e stërvitje për trupat e tyre delikatë, si injeksione zhvilluese e si trajnim Hyjnor që t'i bëjë ata të përballojnë në të ardhmen vështirësitë e jetës dhe mundimet; që përveç shembujve të shumtë të urtësisë që i përkasin jetës së fëmijës në këtë dynja dhe jetës së tyre shpirtërore, ajo e pastron jetën e të vegjëlve me një pastrim shpirtëror ashtu siç e pastron jetën e të mëdhenjve me shlyerje të mëkateve.

Sëmundjet janë si gjilpëra -injektive- të cilat sigurojnë paracaktimin shpirtëror të fëmijës në të ardhmen ose në Ahiret; dhe se meritat që vijnë nga sëmundje të tilla kalojnë

tek veprat e mira të prindërve dhe në mënyrë të veçantë tek nëna e cila nëpërmjet misterit të dhembshurisë preferon shëndetin e fëmijës mbi shëndetin e saj, ashtu siç vërtetohet tek njerëzit e Hakikatit - Realitetit.

Sa për përkujdesjen ndaj të moshuarve, vërtetohet në rrëfenja të shëndosha dhe nga shumë ngjarje historike se së bashku me marrjen e një shpërblimi të madh, të marrësh duatë e të moshuarve dhe veçanërisht të prindërve, t'i gëzosh zemrat e tyre dhe t'u shërbesh me besnikëri e singëritet, ky është boshti i lumturisë për njeriun si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër. Dhe është vërtetuar gjithashtu nga shumë ngjarje se fëmija fatlum i cili i respekton dhe u bindet prindërve të tij të pafuqishëm do të trajtohet në të njëjtën mënyrë nga fëmijët e tij dhe se në qoftë se një fëmijë fatkeq i lëndon e i plagos prindërit e tij, do të ndëshkohet me shumë fatkeqësi si në këtë botë ashtu dhe në tjetrën.

Po, të kujdesesh jo vetëm për të afërmit që janë të moshuar apo për të pafajshmit, por gjithashtu edhe për besimtarët nëse njeriu do t'i haste, meqenëse nëpërmjet misterit të besimit ndodhet një vëllazëri e vërtetë, dhe t'i shërbesh me singëritet e përkushtim një besimtari të sëmurë të moshuar i cili ka nevojë

dhe është i denjë për respekt, kjo kërkohet nga islami.

Ilaçi i Njëzet e Pestë

O vëllezërit e sëmure! Në qoftë se dëshironi një ilaç të dobishëm dhe të shenjtë dhe një balsam për çdo sëmundje, i cili përmban një kënaqësi të vërtetë, zhvilloje besimin tënd! Domethënë, nëpërmjet pendimit dhe të kërkuarit falje dhe të pesë namazeve të detyruara dhe adhurimit, përdore besimin, atë ilaç të shenjtë dhe mjekimin që buron nga besimi.

Po, për shkak të dashurisë së kësaj dynjaje dhe lidhjes së fortë me të, të pakujdesurit janë bërë sikur të ishin qenie jolëndore të sëmura aq të mëdha sa dynjaja. Ne e kemi provuar në shumë pjesë të Risale-i Nurit se besimi i shëron menjëherë ato qenie jolëndore të cilat dërrmohen e shkallmohen nga goditjet e vdekjes dhe të ndarjes, i kuron plagët e tyre dhe i shëron me të vërtetë. Duke mos dashur të zgjatëm, unë po e përmbledh diskutimin tim siç vijon:

Sa për ilaçin e besimit, ai e shfaq efektin e tij nëpërmjet zbatimit të detyrave të tua fetare me sa të kesh mundësi.

Pakujdesia, shthurja, dëshirat e ulëta të nefsit dhe zbavitjet e paligjshme e pengojnë

efektshmërinë e atij ilaçi. Meqenëse sëmundja e largon pakujdesinë dhe i pret orekset - dëshirat- dhe është një pengesë për kënaqësitë e paligjshme, atëherë përfitoni prej saj dhe përdorni ilaçin e besimit të vërtetë dhe dritat e tij të shenjta me pendesë, me istigfar -kërkim falje-, me dua e duke shpresuar...

Allahu ju dhëntë shëndet e shërim dhe i bëftë sëmundjet tuaja si shlyerje për gjynahet tuaja. Amin! Amin! Amin!

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي هَدَيْنَا لِهَذَا وَمَا كُنَّا لِنَهْتَدِيَ لَوْلَا
 أَنْ هَدَيْنَا اللَّهُ لَقَدْ جَاءَتْ رَسُولُ رَبِّنَا بِالْحَقِّ
 سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا إِنَّكَ أَنْتَ الْعَلِيمُ
 الْحَكِيمُ

اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى سَيِّدِنَا مُحَمَّدٍ طِبِّ الْقُلُوبِ وَ دَوَائِهَا
 وَ عَافِيَةِ الْأَبْدَانِ وَ شِفَائِهَا وَ نَوْرِ الْأَبْصَارِ وَ ضِيَائِهَا
 وَ عَلَى آلِهِ وَ صَحْبِهِ وَ سَلِّمْ

Ndërsa ata thonë:

“Gjithë lavdërimet e falënderimet janë për Allahun i Cili na udhëzoi ne për këtë vend. Kurrë nuk do të kishim gjetur ne drejtimin, po të mos na kishte udhëhequr Allahu. Vërtet që

të Dërguarit e Allahut tonë erdhën me të vërtetën”.¹²

“Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga çna ke mësuar Ti. Vërtet që vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti”.¹³

O Allah! Jepi bekime shkëlqesisë sonë Muhammedit,

mjekësisë për zemrat tona dhe ilaçit për to,
shëndetit të mirë për trupat tanë dhe
shërimit të tyre,

dhe dritës së syve tanë dhe shkëlqimit të
tyre,

dhe familjes së tij dhe sahabëve,

dhe jepu atyre paqe.



¹² Kur'an, 7: 42

¹³ Kur'an, 2: 32

LETRA E SHTATËMBËDHJETË

[Shtojca e Shkreptimës së Njëzet e Pestë]

NJË LETËR NGUSHËLLIMI PËR VDEKJEN E NJË FËMIJE

بِسْمِهِ وَإِنْ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا يَسْبِحُ بِحَمْدِهِ

Me Emrin e Tij

“Nuk ka asgjë që të mos e madhërojë Atë duke e falënderuar (me hamd).” ¹⁴

Vëllai im i dashur i Ahiretit, Hafiz Halid Efendi!

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
وَبَشِّرِ الصَّابِرِينَ الَّذِينَ إِذَا أَصَابَتْهُمُ مُصِيبَةٌ قَالُوا إِنَّا
لِلَّهِ وَإِنَّا إِلَيْهِ رَاغِبُونَ

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti! “Dhe jepu lajme të gëzueshme durimtarëve të cilët thonë kur u bie fatkeqësi, ‘Vërtet të Allahut jemi dhe padyshim tek Ai do të kthehemi.’” ¹⁵

¹⁴ Kur'an, 17: 44

¹⁵ Kur'an, 2: 155-156

Vëllai im, vdekja e fëmijës tënd më ka pikëlluar. Por **أَلْحَكُمُ لِلَّهِ** “Urdhri është i Allahut,” kënaqësia me vendimin Hyjnor dhe nënshtrimi ndaj Kaderit Hyjnor është një kusht i Islamit. Allahu i Gjithëfuqishëm ju dhëntë ju të gjithëve durim. Dhe Allahu e bëftë të ndjerin një mbështetës dhe ndërmjetësues për ju në Ahiret. Unë do të shpjegoj “Pesë Pika” të cilat janë vërtet Lajme të Mira dhe ngushëllim real për ju dhe për besimtarët e devotshëm si ju.

Pika e Parë: Kuptimi i frazës: **وَلَدَانِ مُحَلَّدُونَ**
 “(Do t’ju shërbejnë) djelmosha të pavdekshëm.”¹⁶ në Kur’anin e gjithurtë është ky: Me këtë frazë, vërseti tregon dhe jep lajme të gëzueshme se fëmijët e besimtarëve të cilët vdesin para se të arrijnë pjekurinë, do të qëndrojnë përjetë si të amshuar, fëmijë të dashur në një formë të denjë për parajsë, se ata do të jenë mjet i përhershëm lumturie në përqaftimin e baballarëve të tyre dhe të nënave të cilët shkojnë në Parajsë; se ata do të jenë mjeti për të siguruar për prindërit e tyre më të ëmblën e kënaqësive si dashuria dhe përkëdhelja e fëmijëve.

¹⁶ Kur’an, 56: 17

Meqenëse të gjitha gjërat e këndshme do të gjenden në Xhennet, atëherë pohimet e atyre që thonë se “Parajsa nuk është vend për riprodhim dhe nuk do të ketë dashuri e përkëdhelje fëmijësh” nuk janë të sakta. Përkundrazi; atje është fitimi më i madh me dashurinë dhe përkëdheljen e pastër e pa dhimbje të fëmijëve të amshuar gjatë miliona viteve, në vend të një kohe të shkurtër si dhjetë vitet e dashurisë dhe të përkëdheljes së fëmijëve të përziara me hidhërime në këtë dynja. Të gjithë këto e vërteton vërseti Kur’anor me frazën: وَلَدَانٌ مُّخَلَّدُونَ “Djelmosha të pavdekshëm”, dhe ky është një burim i madh lumturie për besimtarët.

Pika e Dytë: Një herë, një njeri ishte në burg. Ata i dërguan atij njërin nga fëmijët e tij të dashur. I burgosuri fatkeq vuajti edhe nga pikëllimet e veta dhe, meqenëse nuk mundi ta bënte fëmijën e tij të rehatohej, ai u pikëllua gjithashtu në mundimin e tij. Ndërkohë sundimtari zemërdhembshur i dërgoi një njeri atij me një mesazh i cili i tha:

“Sigurisht ky fëmijë është i yti, por ai është nënshetasi im dhe nga njerëzit e mi. Unë do ta marr atë, do të kujdesem për të dhe do ta ushqej në një pallat të bukur.”

Njeriu nisi të qajë me ankth e angështi, dhe tha: “Unë nuk do të ta jap fëmijën tim i cili është ngushëllimi im!”

Shokët e tij në burg i thanë: “Brenga jote është e pakuptim. Në qoftë se ty të dhimbset fëmija e të vjen keq për të, mësoje se ai do të shkojë tek një pallat madhështor i gjerë dhe lumturie në vend të këtij burgu të ndyrë, të neveritshëm dhe pikëllues. Në qoftë se ti pikëllohesh për veten tënde dhe po kërkon përfitimet dhe dobitë e tua, nëse fëmija jot mbetet këtu, ti do të vuash shumë hidhërime e dhimbje tek vështirësitë e fëmijës për hir të përfitimit tënd të vetëm të dyshimtë e të përkohshëm. Në qoftë se ai shkon atje, do të ketë një mijë avantazhe për ty, sepse ai do të jetë shkak për tërheqjen e mëshirës së Mbretit dhe do të jetë si një ndërmjetës për ty. Mbreti do të dëshirojë që të të bëjë ty të takohesh me të. Sigurisht, ai nuk do ta dërgojë atë në burg me qëllim që ti të mund ta shohësh; ai do të të lirojë ty nga burgu, do të të dërgojë ty tek ai pallat dhe do të të lejojë të takohesh me fëmijën atje, por me kusht që ti të kesh besim tek mbreti dhe t’i bindesh Atij...”

Vëllai im i dashur! Në dritën e këtij krahasimi, ti duhet të mendosh sa vijon, ashtu si ti, duhet të mendojnë edhe besimtarët e tjerë kur u vdesin fëmijët e tyre: Fëmija ishte i

pafajshëm dhe Krijuesi i tij është Mëshirëplotë dhe Gjithëbujar. Ai e ka marrë atë tek Mëshira dhe tek përkujdesja e Tij e plotë në vend të edukimit dhe të dhembshurisë sime të mangët për të. Ai e ka liruar atë nga burgu i trishtueshëm, i kobshëm dhe i vështirë i kësaj bote dhe e ka dërguar atë në kopshtet e Parajsës së Tij. O sa lumturi për atë fëmijë! Në qoftë se ai do të kishte qëndruar në këtë dynja, kush e di se si do të sillej dhe çfarë do të punonte.

Prandaj, mua nuk më vjen keq për të, përkundrazi, unë e shoh atë të jetë i gëzuar, fatlum. Sa për dobitë që mbeten për veten time, mua nuk më vjen keq për to dhe as nuk pikëllohem e të jem i brengosur, sepse në qoftë se do të kishte mbetur në dynja, ai do të kishte siguruar dhjetë vite të një dashurie të përkohshme fëmije të përziëra me dhimbje. Në qoftë se ai do të kishte qenë i drejtë dhe në qoftë se do të kishte qenë i aftë në çështjet e dynjasë, ndoshta ai do të më kishte ndihmuar mua. Por me vdekjen e tij, ai është bërë si ndërmjetësues i cili është mjeti për të garantuar një dashuri fëmije prej dhjetë milion vitesh në Parajsën e amshuar dhe për të hyrë në lumturinë e përjetshme. Sigurisht, ai që humbet ndonjë përfitim të dyshimtë të çastit dhe fiton një mijë dobi të sigurta, të

shtyra për më vonë, ai nuk shfaq hidhërim e brengë, ai nuk qan në dëshpërim.

Pika e Tretë: Fëmija që ka vdekur ishte vetëm se krijesë e një Krijuesi Gjithëbujar dhe një rob i Tij, dhe së bashku me të gjitha gjymtyrët e tij është artifakti i Tij, dhe i përket Atij; ai ishte një shok për prindërit e tij, i cili iu ishte dhënë përkujdesjes së tyre përkohësisht. Ai i bëri babain dhe nënën shërbyes për fëmijën e tyre. Si shpërblim për ato shërbime të tyre, Ai u dha atyre dhembshuri të këndshme si një shpërblim i shpejtë. Tani, në qoftë se, si kërkesë e mëshirës dhe e urtësisë, Ai Krijues Mëshirëplotë, i Cili është Pronari i vërtetë i fëmijës, që ka në pronësi nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë pjesë prej një mijë pjesëve të fëmijës, e merr fëmijën prej teje dhe i jep fund shërbimit tënd, atëherë të qash në dëshpërim e pikëllim për shkak të asaj pjese të vetme të dukshme, të jashtme, përpara Pronarit të vërtetë të një mijë pjesëve në një mënyrë që të kujton ankesën, kjo nuk i ka hije besimtarit, përkundrazi kjo u përshtatet njerëzve të pakujdesisë dhe të çudhëzimit.

Pika e Katërt: Në qoftë se dynjaja do të kishte qenë e përjetshme dhe, në qoftë se njeriu do të mbetej në të përjetësisht, ose në qoftë se ndarja do të kishte qenë përjetësisht, atëherë brenga pikëlluese dhe dhimbja

dëshpëruese do të kishin ndonjë kuptim. Por, meqenëse kjo dynja është një bujtinë, dhe atje ka shkuar fëmija i vdekur, edhe ti, edhe ne gjithashtu, do të shkojmë atje. Për më tepër, kjo vdekje nuk është e veçantë për të, përkundrazi, ajo është një rrugë që e përshkojnë të gjithë. Dhe meqenëse ndarja nuk është përgjithmonë, ai do të takohet në të ardhmen, si në botën e ndërmjetme, ashtu edhe në Ahiret e në Xhennet.

Prandaj njeriu duhet të thotë: **اَلْحُكْمُ لِلّٰهِ** "Urdhri është i Allahut." Ai e dha atë dhe Ai e mori përsëri. Dhe gjithashtu njeriu duhet të thotë: "I gjithë lavdërimi i takon Allahut, xh.sh., për çdo gjendje!", dhe të bëjë falënderime me durim.

Pika e Pestë: Dhembshuria, njëra nga manifestimet më të holla, më të bukura, më të këndshme dhe më të ëmbëla të Mëshirës Hyjnore, është një eliksir i ndritshëm. Ajo është më e mprehtë se sa dashuria e apasionuar, e zjarrtë. Dhe ajo është mjeti më i shpejtë për të arritur tek i Vërteti, Allahu i Gjithëfuqishëm. Ashtu si dashuria metaforike dhe dashuria për dynjanë të cilat transformohen në dashuri të vërtetë me vështirësinë më të madhe dhe e gjejnë Allahun e Gjithëfuqishëm, po ashtu

dhembshuria (mëshira) –por pa vështirësi- e lidh zemrën me Allahun, xh.sh., që ta çojë njeriun tek Allahu, xh.sh., nëpërmjet një rruge më të shkurtër dhe në një mënyrë më të pastër. Që të dy, babai dhe nëna e duan fëmijën e tyre më shumë se sa gjithë dynjanë. Kur fëmija e tyre u merret atyre të dyve, në qoftë se ata janë fatbardhë dhe në qoftë se janë besimtarë të vërtetë, ata i largojnë fytyrat e tyre nga dynjaja, i kthejnë kurrizin dynjasë, gjejnë Dhuruesin e Vërtetë të mirësive dhe thonë: “Meqenëse dynjaja është e përkohshme, atëherë ajo nuk është e denjë që të lidhësh zemrën me të..” Kudo që të ketë shkuar fëmija, ata gjejnë një lidhje me atë vend dhe fitojnë një rang shpirtëror të lartë.

Njerëzit e shkujdesjes dhe të çudhëzimit janë të privuar nga lumturia dhe nga lajmet e gëzueshme të këtyre “Pesë pikave”. Ju mund të shikoni nga sa vijon se sa pikëlluese është situata e tyre: Ata e shohin fëmijën e tyre të vetëm në agonitë e vdekjes dhe për shkak se ata e imagjinojnë dynjanë të jetë e përjetshme dhe, si një rezultat i shkujdesjes së tyre dhe çudhëzimit, ata e mendojnë se vdekja është mosekzistencë dhe ndarje e përjetshme. Ata mendojnë menjëherë gjumin e tij në dheun e varrit në vend të shtratit të tij të butë dhe, për shkak të shkujdesjes së tyre dhe

pavëmendshmërisë, ata nuk mendojnë për Parajsën e mëshirës dhe qiellin e mirësisë së të Gjithëmëshirshmit Mëshirëplotë. Ju mund ta krahasoni se çfarë brengje pikëlluese dhe çfarë dhimbje vuajnë ata. Ndërsa besimi dhe Islami që janë mjete për të dyja botët, i thonë besimtarit: Krijuesi i tij Mëshirëplotë do ta nxjerrë këtë fëmijën tënd, i cili është në agonitë e vdekjes, nga kjo dynja e përkohshme dhe do ta çojë atë në Parajsë. Ai do ta bëjë atë edhe ndërmjetësues për ty, edhe një fëmijë të përjetshëm. Ndarja është e përkohshme, prandaj mos u shqetëso;

duro pak, dhe thuaj

اَلْحُكْمُ لِلّٰهِ * اَنَا لِلّٰهِ وَاَنَا اِلَيْهِ رَاجِعُونَ

“Urdhri është i Allahut. Allahut ne i përkasim dhe tek Ai do të kthehemi.”

اَلْبَاقِي هُوَ الْبَاقِي

I Qëndrueshmi i vetëm. Ai është i
Qëndrueshmi i Vetëm!

Said Nursi



SHKREPTIMA E DYTË

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
اِذْ نَادَىٰ رَبَّهُ اِنِّیْ مَسْنِیَ الضَّرِّ وَاَنْتَ اَرْحَمُ الرَّاحِمِیْنَ

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

“Kujto edhe Ejjubin a.s. kur ai i thirri Allahut të Tij: Vërtet që më ka kapur mjerimi dhe Ti je më Mëshiruesi i mëshiruesve”.¹⁷

Duaja e Ejjubit a.s., kampioni i durimtarëve, është edhe e mirësprovuar, edhe e efektshme. Edhe ne duhet të marrim nga drita e këtij vërseti dhe të themi në lutjet tona:

رَبِّ اِنِّیْ مَسْنِیَ الضَّرِّ وَاَنْتَ اَرْحَمُ الرَّاحِمِیْنَ

'O Allahu im ! Vërtet që më ka kapur mjerimi, dhe Ti je më Mëshiruesi i Mëshiruesve.'

Thelbi i tregimit të mirënjohur të Ejjubit a.s. është sa vijon:

¹⁷ Kur'an, 21: 83

Ndërsa i vuajtur e i munduar me plagë të shumta dhe me lëndime për një kohë të gjatë, ai thirri dhe shpresoi një shpërblim të madh për sëmundjen e tij nga i Lartësuari i Vetëm i Gjithëfuqishëm dhe e përballoi sëmundjen me durimin më të madh. Por më vonë, kur krimbat e shkaktuar nga plagët e tij depërtuan tek zemra dhe tek gjuha e tij, të cilat janë vendi i përmendjes së Allahut, xh.sh., dhe vendi i njohjes së Tij, ai u frikësua se detyra e tij e adhurimit do të pësonte goditje e dëm dhe prandaj tha në dua, jo për hir të qetësisë së tij, po për hir të adhurimit të tij ndaj Allahut:

“O Allah! Vërtet që më ka kapur mjerimi dhe Ti je më Mëshiruesi i mëshiruesve”,

“O Allah! Dëmi ka rënë mbi mua; përmendja ime Ty me gjuhën time dhe adhurimi im ndaj Teje me zemrën time do të pësojnë dëm”. Atëherë, Allahu i Lartësuar e i Gjithëfuqishëm ia pranoi atë lutje të sinqertë, të pastër e të përsëritshme në një mënyrë të mrekullueshme. Ai i dhuroi Hazreti Ejjubit shëndet të mirë të plotë dhe shfaqti tek ai të gjitha llojet e mëshirës.

Kjo Shkreptimë përmban Pesë Pika:

Pika e Parë

Duke u korresponduar atyre plagëve të jashtme dhe sëmundjes me të cilat u godit

Ejjubi a.s., edhe ne kemi sëmundje të shpirtit dhe të zemrës. Në qoftë se qenia jonë e brendshme do të kthehej e të dilte jashtë dhe qenia jonë e jashtme do të kthehej brenda, ne do të dukeshim më shumë të plagosur e të sëmurë se sa Ejjubi a.s..

Çdo mëkat që ne bëjmë dhe çdo dyshim që hyn në mendjen tonë, shkakton plagë në zemrën dhe në shpirtin tonë.

Plagët e Ejjubit a.s. ishin të një natyre të tillë që kërcënonin jetën e tij të shkurtër të kësaj bote, kurse plagët tona të brendshme kërcënojnë jetën tonë të gjatë të amshuar të Ahiretit. Ne kemi një mijë herë më shumë nevojë për duanë e Ejjubit a.s. se sa kishte nevojë vetë ai. Ashtu siç depërtuan në zemrën dhe në gjuhën e tij krimbat që u shkaktuan nga plagët e tij, po ashtu vesveset, tundimet dhe dyshimet që rezultojnë tek ne nga plagët që shkaktohen nga gjynahet dhe mëkatet - ruajna Allah!- do të futen në brendësi të zemrës, e cila është vendi i besimit dhe, kështu plagosim e lëkundim imanin; gjithashtu ato do të preknin edhe gjuhën, e cila është interpretuesja e imanit, dhe plaçkisin prej saj kënaqësinë e dhikrit dhe ëndjen shpirtërore, dhe vazhdojnë ta ftohin e ta largojnë nga dhikri -përmendja e Allahut, xh.sh.- derisa ta heshtin atë plotësisht.

Mëkati, duke depërtuar në zemër, do ta nxijë e do ta errësojë atë derisa ta shuajë dritën e besimit. Brenda çdo mëkati është një rrugë që të çon në mosbesim. Në qoftë se ai mëkat nuk pastrohet, nuk fshihet menjëherë nëpërmjet istigfarit -kërkimit të faljes-, ai transformohet në krim jolëndor, madje shndërrohet në një gjarpër që kafshon zemrën dhe e lëndon.

Për shembull, një njeri që kryen fshehtas një mëkat të turpshëm, do t'i frikësohej e druhej turpërimit që shkaktohet nëse të tjerët janë në dijeni të atij mëkati. Kështu ekzistenca e engjëjve dhe e qënieve shpirtërore do të jetë e rëndë për të që ta durojë; dhe ai do të dëshironte ta mohonte atë, madje edhe me fuqinë e treguesit më të vogël.

Dhe për shembull, ai që bën një gjynah të madh që meriton ndëshkimin e Xhehenemit, në qoftë se nuk do të mbrohej e fortifikohej përballë atij mëkati nëpërmjet istigfarit -kërkimit të faljes- dhe pendesës, ai do të dëshironte me gjithë zemër mosekzistencën e Ferrit sa herë që ai dëgjon kërcënimet e tij dhe, madje ai do të guxonte ta mohonte Ferrin edhe me fuqinë e treguesit më të vogël dhe të dyshimit.

Dhe për shembull, ai që nuk i kryen namazet e detyruara dhe që nuk i përmbush

detyrat e tij të adhurimit, do të preket e lëndohet nga dëshpërimi e nga ankthi, ashtu siç do të ishte i pikëlluar në ndonjë rast kur nuk përfill një detyrë të vogël ndaj një sunduesi të thjeshtë. Kështu dembelia e tij në përmbushjen e detyrës, pavarësisht urdhëresave të përsëritura që lëshohen nga Allahu i Madhërishëm, do ta hidhërojnë shumë atë dhe do t'i shkaktojnë një ngushtësi të fortë dhe një errësirë në shpirtin e tij. Kjo ngushtësi do të nxiste një dëshirë tek ai dhe të thoshte me vete: “Ah sikur Ai të mos kishte dhënë urdhër për kryerjen e atij ibadeti”; dhe nga kjo dëshirë do të lindte dëshira për të mohuar Allahun dhe për të ushqyer armiqësi ndaj Tij. Në qoftë se do të vinte ndonjë dyshim në zemrën e tij lidhur me ekzistencën e Krijuesit, ai do të prirej e anonte nga ai - dyshimi- sikur ai të ishte një provë vendimtare. Një portë e madhe shkatërrimi do të hapej përpara tij. Por ky fatzi nuk e kupton se e ka bërë veten -nëpërmjet këtij mohimi- objekt për ngushtësi shpirtërore e për hidhërim miliona herë më të rëndë e më të tmerrshëm se sa ai shqetësim i vogël që ndiente nga dembelia ndaj detyrës së adhurimit; është tamam si ai që ikën nga pickimi i mushkonjës për tek kafshimi i gjarpërit.

Le të kuptohet në dritën e këtyre tre shembujve misteri i vërsetit Kur'anor,

بَلْ رَانَ عَلَى قُلُوبِهِمْ

“Jo, kurrë nuk është kështu! Por zemrat e tyre janë të njolloosura (prej gjynaheve) që ata patën fituar”.¹⁸

Pika e Dytë

Ashtu siç u shpjegua në Fjalën e Njëzet e Gjashtë, lidhur me Kaderin Hyjnor, njerëzit nuk kanë të drejtë të ankohen në raste fatkeqësish dhe sëmundjesh për tre arsye e mëposhtme:

Arsyeja e Parë: Allahu, xh.sh., e ka bërë mantelin e trupit, me të cilin Ai e ka veshur njeriun, një manifestim të artit të Tij. Ai e ka bërë njeriun të jetë një model mbi të cilin Ai pret, rregullon, zbukuron, modifikon e ndryshon mantelin e trupit, duke shfaqur kështu manifestimin e Emrave të Tij të ndryshëm. Ashtu si Emri El-Shafi Shëruesi, që bën të domosdoshëm ekzistencën e sëmundjes, gjithashtu Emri Er-Rezak, Furnizuesi, kërkon ekzistencën e urisë; dhe kështu me radhë...

¹⁸ Kur'an, 83: 14

مَالِكُ الْمَلِكِ يَتَصَرَّفُ فِي مُلْكِهِ كَيْفَ يَشَاءُ

Pronari i gjithësundimit vepron si të dojë me autoritet absolut mbi pronën e Tij.

Arsyeja e Dytë: Nëpërmjet fatkeqësive dhe sëmundjeve jeta pastrohet, përsoset, forcohet dhe përparon; domethënë arrin rezultate, fiton plotësim dhe përmbush qëllimin e saj. Ndërsa jeta që, në mënyrë të pandryshueshme, monotone, kalon mbi divanin e rehatisë dhe mbi shtratin e lehtësisë i ngjason më shumë mosekzistencës e cila është thjesht e keqe e pastër se sa ekzistencës e cila është thjesht e mirë e pastër. Në fakt ajo ka prirje të shkojë drejt mosekzistencës.

Arsyeja e Tretë: Kjo banesa e dynjasë është një fushë provimi, është banesë e shërbimit dhe vendi i punës dhe i ibadetit. Ajo nuk është vendi i kënaqësisë, i ëndjes dhe i marrjes së shpërblimit. Meqenëse banesa e dynjasë është vendi i punës dhe i ibadetit, atëherë sëmundjet dhe fatkeqësitë -për sa kohë që ato nuk prekin besimin dhe përballohen me durim- janë në harmoni të plotë me shërbimin dhe adhurimin, dhe madje ato i forcojnë ato. Meqenëse ato sëmundje e fatkeqësi e bëjnë adhurimin e një ore të barasvlershëm me atë të një dite, njeriu në vend të ankesave duhet të japë falënderime.

Adhurimi, në fakt, përbëhet nga dy lloje: Njëri pozitiv, dhe tjetri negativ.

Lloji i parë, pozitiv, është i qartë për të gjithë. Sa për adhurimin negativ, ky është se, kur njeriu goditet me fatkeqësi ose me sëmundje ai kupton dhe ndjen dobësinë e tij dhe paaftësinë, dhe duke u kthyer tek Krijuesi i tij Mëshirëplotë, kërkon strehim tek Ai, mendon për Të, i lutet Atij, dhe kështu ai kryen një formë të pastër adhurimi në të cilën nuk futet fare hipokrizia. Në qoftë se njeriu e përballon me durim, mendon për shpërblimin që vjen nga Allahu në raste fatkeqësish, dhe jep falënderime, atëherë çdo orë që ai kalon do të vlerësohet e quhet si një ditë e plotë e harxhuar në adhurim. Jeta e tij e shkurtër bëhet shumë e gjatë. Madje ka raste në të cilat një minut konsiderohet i barasvlershëm me adhurimin e një dite të plotë.

Njëherë unë isha shumë i mërzitur për shkak të një sëmundjeje të rëndë që goditi njërin nga vëllezërit e mi të Ahiretit, Muhaxhir Hafiz Ahmedin. Por ndërkohë zemrës sime i erdhi një paralajmërim, siç vijon:

“Përgëzoje atë dhe uroje! Çdo minut që ai kalon vlerësohet si adhurimi i një dite të plotë”

Ai, në të vërtetë, po shprehte falënderime ndaj Krijuesit të tij Mëshirëplotë duke e përballuar sëmundjen e tij me durim.

Pika e Tretë

Ashtu siç e kemi shpjeguar në një ose dy nga Fjalët e mëparshme, sa herë që dikush mendon për të kaluarën e jetës së tij, ai do të thoshte në zemrën e tij apo me gojën e tij ose 'oh, sa keq!' ose EL-hamdu lil-lah. Domethënë, ai ose do të shprehte keqardhje, ose do të thonte Falënderimet dhe Lavdërimi i takojnë Allahut. Keqardhja frymëzohet nga dhimbjet që burojnë nga ndërprerja e kënaqësive të mëparshme dhe nga ndarja prej tyre. Sepse ndërprerja e kënaqësisë është një dhimbje në vetvete. Ndonjëherë një kënaqësi e çastit shkakton dhimbje të përhershme. Të menduarit për të do ta shtypte e shtrydhte atë plagë dhe do të pikonte prej saj pikëllimi e keqardhja. Ndërsa kënaqësia e vazhdueshme shpirtërore që buron nga ndërprerja e zhdukja e dhimbjeve të përkohshme të cilat i ka kaluar njeriu në të shkuarën e jetës së tij, e bëjnë gjuhën e tij të shprehë falënderime e lavdërimi për Krijuesin, duke e nxitur njeriun të thotë El-Hamdu lil-lah! Përveç kësaj prirjeje të brendshme të njeriut, në qoftë se ai do të mendonte për shpërblimin që rezulton nga

fatkeqësia dhe për thevabin që e pret atë në Ahiret, në qoftë se ai do të kuptonte se jeta e tij e shkurtër me fatkeqësi do të transformohet në një jetë të gjatë, atëherë ai nuk do të ishte thjesht dhe vetëm durimtar, por do të ngjitej në shkallën e mirënjohjes ndaj Allahut, xh.sh., dhe do të ishte i kënaqur me Kaderin e Tij. Gjuha e tij do të niste të bëjë falënderime e lavdërime duke thënë:

El-Hamdu lil-lah ala kul-li halin sivel-kufri ved-dalali. “Lavdi Allahut për çdo gjendje përveç mohimit e çudhëzimit.”

Është bërë proverbë tek njerëzit thënia: “Sa e gjatë është koha e fatkeqësisë”. Po, ashtu është, veçse ama jo për shkak se ajo është e mërzitshme dhe pikëlluese ashtu siç imagjinojnë njerëzit zakonisht, por për shkak se ajo fiton rezultate të mëdha jetësore ashtu si një jetë e gjatë.

Pika e Katërt

Ashtu siç u shpjegua në Stacionin e Parë të Fjalës së Njëzet e Një, në qoftë se njeriu nuk e shpërndan forcën e durimit të cilën ia ka dhënë Allahu, xh.sh., dhe nuk e shpërndan nëpër frikësime e dyshime të pabaza, ajo forcë mund të jetë e mjaftueshme për të qëndruar përballë çdo fatkeqësie e belaje, mirëpo nëpërmjet mbisundimit të iluzionit e të

mashttrimit, mospërfillja e njeriut dhe të imagjinuarit e tij këtë jetë të përkohshme si të përhershme, ai e shpërndan forcën e tij të durimit mbi dhimbjet e së shkuarës dhe mbi ankthet e së ardhmes, dhe si rrjedhojë, nuk i mjafton durimi që ia ka dhënë Allahu, xh.sh., për të mbajtur fatkeqësinë që i bie dhe për t'i bërë ballë asaj, dhe fillon të ankohet. Kjo është -ruajna Allah!- sikur ai t'i ankohej Allahut për njerëzit. Në mënyrën më të pajustificuar dhe madje të marrë, ai ankohet dhe demonstroi mungesën e tij të durimit.

Në qoftë se dita që kaloi pati fatkeqësi, pikëllimi tashmë ka ikur, dhe vetëm qetësia mbetet; dhimbja është zhdukur dhe me ndërprerjen e saj mbetet kënaqësia; brenga ka ikur dhe mbetet shpërblimi. Prandaj njeriu nuk duhet të ankohet, por të japë falënderime për kënaqësinë. Njeriu nuk duhet të zemërohet nga fatkeqësia, por duhet ta dojë. Jeta e përkohshme e së shkuarës konsiderohet si një jetë e përhershme dhe e bekuar për shkak të fatkeqësisë. Do të ishte marrëzi nëse njeriu e shpërndan një pjesë të durimit të tij dhe e humbet me iluzione dhe duke menduar mbi dhimbjet dhe fatkeqësitë e kaluara.

Për sa ka të bëjë me ditët që do të vijnë, meqenëse ato nuk kanë ardhur akoma, të mendosh qysh tani për sëmundjet dhe

fatkeqësitë që do të shkaktohen gjatë tyre dhe të shfaqësh padurim, është gjithashtu marrëzi.

Ashtu siç do të ishte marrëzi nëse njeriu do të hante sot shumë bukë dhe do të pinte shumë ujë se ndoshta mund të goditet nga uria dhe etja nesër ose mbasnesër, po ashtu të hidhërohesh e të mërzhitesh qysh tani se mbase do të sprovohesh me sëmundje e fatkeqësi në të ardhmen të cilat ato tani janë mosekzistuese; të vuash që tani prej tyre, të shfaqësh padurim dhe ta shtypësh e ta mbytësh veten pa ndonjë shtrëngim, është një çmenduri e tillë e cila nuk meriton më keqardhje e mëshirë.

Shkurtazi: Ashtu siç e shton mirënjohja mirësinë Hyjnore, po ashtu ankesa e rrit fatkeqësinë, dhe largon mëshirën dhe keqardhjen për njeriun që është goditur.

Gjatë luftës së Parë botërore, një njeri i bekuar në Erzurum u godit me një sëmundje të rëndë. Unë shkova për ta vizituar dhe ai më tha duke u ankuar hidhur:

“Unë, nuk kam qenë në gjendje ta vë kokën në jastëk e të fle që prej njëqind netësh”. Unë u dëshpërova shumë. Papritmas më erdhi një mendim dhe thashë:

“Vëlla, njëqind ditët e vështira që ke kaluar janë tani si njëqind ditë të lumtura. Mos mendo për to dhe mos u anko! Por shikoji nga këndvështrimi i zhdukjes dhe i ikjes së tyre, dhe falënderoje Krijuesin tënd për to. Sa për ditët e ardhme, meqenëse ato ende nuk kanë ardhur, vendose besimin në Krijuesin tënd të Gjithëmëshirshëm e Mëshirëplotë dhe rri i qetë. Mos qaj para se të goditesh, mos u tremb nga asgjëja dhe mos ia jep mosqenies ngjyrën e qënies. Mendo pikërisht për orën e tanishme; forca jote e durimit është e mjaftueshme për të bërë qëndresë për këtë orë. Mos vepro si ai komandant i çmendur i cili i shpërndau forcat e tij në qendër nga e djathta dhe nga e majta në një kohë kur krahu i majtë i armikut iu bashkua krahut të djathtë të ushtrisë së tij duke e përforcuar dhe në kohën kur krahu i djathtë i armikut nuk ishte bërë akoma gati për luftë.. Dhe sapo e mësoi këtë armiku, mobilizoi një forcë shumë të vogël në qendër dhe atëherë e shkatërroi qendrën e tij që u la e dobët, dhe ia shpartalloi ushtrinë e tij.

O vëlla, mos ji si ai. Mobilizojë të gjithë forcën tënde për këtë orë të tanishme dhe mendo për mëshirën Hyjnore, për shpërblimin në Ahiret dhe si jeta jote e shkurtër dhe kalimtare transformohet në një

jetë të gjatë e të përhershme. Në vend që të ankohesh me hidhërim, jep falënderime të gëzueshme”.

Ai person u lehtësua shumë dhe tha: “Lavdërimet dhe falënderimet i takojnë Allahut, tani sëmundja ime është një e dhjeta e asaj që ishte më parë”.

Pika e Pestë përbëhet nga tre çështje.

Çështja e Parë: Fatkeqësia e cila quhet vërtet fatkeqësi dhe është vërtet e dëmshme është ajo e cila prek e dëmton fenë. Duhet patjetër të kërkojmë strehim tek Allahu, xh.sh., në të gjitha kohët, ta hedhim vetveten përpara Tij dhe t’i lutemi me përgjërëm që të na mbrojë nga fatkeqësia në çështjet e fesë dhe të thërrasim për ndihmë. Sa për fatkeqësitë të cilat nuk prekin fenë dhe nuk e dëmtojnë, ato në realitet nuk janë fatkeqësi. Një pjesë nga ato janë paralajmërime nga i Gjithëmëshirshmi i Vetëm për t’i zgjuar nga pakujdesia. Në qoftë se një bari, hedh një gur tek delet e tij kur ato shkelin në kullotën e një tjetri, ato, delet, e kuptojnë se bariu synon, me atë gurë që t’i paralajmërojë dhe t’i shpëtojnë nga një veprim i rrezikshëm e i dëmshëm; kështu ato kthehen në kullotën e tyre me qetësi e mirënjohje.

Po kështu ka shumë fatkeqësi të jashtme të cilat janë paralajmërime Hyjnore, qortime dhe zgjim Hyjnor për njeriun.

Ndërsa pjesa tjetër e fatkeqësive është pendesë e shlyerje e mëkateve.

Gjithashtu një pjesë tjetër prej fatkeqësive shkrin gjendjen e pakujdesisë tek njeriu, i kujton atij dhe e bën të kujtojë pafuqinë dhe varfërinë e tij duke i dhënë kështu një formë qetësie.

Ndërsa fatkeqësia që godet njeriun, e cila është sëmundja, ajo nuk është një fatkeqësi reale, por përkundrazi, ashtu siç është përmendur më parë, ajo është një mirësi Hyjnore dhe një mjet pastrimi prej gjynaheve dhe mëkateve. Ndodhet një hadith profetik i cili thotë:

“Ashtu si një pemë që lëshon frutat e saj të pjekura kur shkundet, po ashtu bien mëkatet e zhduken nëpërmjet goditjes nga ethet.”¹⁹

Dhe kështu Hazreti Ejubi a.s. nuk u lut në duanë e tij për lehtësimin e vetvetes, por kërkoi shërim për qëllimin e adhurimit, kur sëmundja u bë penguese për ta përmendur Allahun me gojë dhe pengim për të reflektuar

¹⁹ Buhari

me zemër në dimensionet e brendshme të gjërave që ka krijuar Allahu, xh.sh.

Ne gjithashtu duhet ta bëjmë qëllimin tonë parësor -kur bëjmë atë dua- shërimin e plagëve tona të brendshme e shpirtërore që burojnë nga mëkatimi.

Për sa ka të bëjë me sëmundjet fizike, ne mund të kërkojmë strehim tek Allahu i Gjithëfuqishëm kur ato pengojnë adhurimin tonë. Por ne duhet të lutemi në një mënyrë të përvuajtur, varfërisht dhe të përshpirtshme, dhe jo me protestë e me ton ankues. Në qoftë se e pranojmë Allahun si Krijuesin tonë dhe si Krijuesin tonë, atëherë ne gjithashtu duhet të pranojmë gjithçka që Ai na jep nëpërmjet Hyjnisë së Tij. Të psherëtish e të ankoresh në një mënyrë që nënkupton protestë e kundërshtim ndaj Kaderit Hyjnor dhe ndaj vendimit, është një lloj kritike ndaj Kaderit Hyjnor, një akuzë e bërë ndaj mëshirës së gjërë Hyjnore. Ai që kritikon Kaderin Hyjnor e përplas dhe e thyen kokën e tij në një kudhër.

Kushdo që akuzon mëshirën e Allahut, xh.sh., në mënyrë të pashmangshme do të privohet nga ajo. Të përdorësh një dorë të thyer për hakmarrje, do t'i shkaktonte vetëm dëmtim të mëtejshëm dorës.

Po kështu, një njeri, i cili është goditur me fatkeqësi, në qoftë se do t'i përgjigjej me ankesë, protestë dhe me mërzitje, fatkeqësia e tij vetëm do të shtohet.

Çështja e Dytë: Fatkeqësitë fizike shtohen kur ato shihen si të mëdha, dhe zvogëlohen kur shihen si të vogla.

Për shembull, sa herë që njeriu i jep rëndësi ndonjë iluzionit që i shfaqet natën në ëndërr, ajo ënjtet e zmadhohet në shikimin e tij; por në qoftë se ai nuk i jep rëndësi, ajo zhduket.

Po kështu, në qoftë se dikush përpiqet të shmangë një sulm që lëshohet nga grerëzat, ato do të bëhen më agresive; ndërsa në qoftë se ai nuk do t'u jepte rëndësi, ato do të shpërndareshin. Kështu, në qoftë se njeriu i shikon fatkeqësitë fizike si të mëdha dhe u jep rëndësi, ato do të shtohen, dhe për shkak të merakut dhe mërzitjes ato kalojnë nga trupi dhe lëshojnë rrënjë në zemër.

Atëherë rezultati do të jetë një goditje e brendshme në zemër tek e cila mbërthehet e lidhet fatkeqësia e jashtme për të vazhduar e për të qëndruar gjatë.

Por në qoftë se mërzitja largohet nëpërmjet pranimit të Kaderit Hyjnor dhe mbështetjes tek Allahu, fatkeqësia fizike do të zvogëlohet,

thahet e zhduket, ashtu si një pemë të cilës i janë prerë rrënjët.

Unë një ditë e përshkrova këtë të vërtetë siç vijon:

Mos bërtit në fatkeqësi, o i mjerë, eja e mbështetu tek Allahu!

Dije se të rënkuarit e shton fatkeqësinë dhe është një gabim i madh.

Gjeje Dërguesin e fatkeqësisë, dhe dije se ajo është një dhuratë brenda dhuratës dhe një kënaqësi.

Në qoftë se nuk e gjen Atë, dije se dynjaja është e gjitha dhimbje brenda dhimbjes, përkohshmëri dhe humbje.

Atëherë pse vajton nga një fatkeqësi e vogël ndërsa mbi ty është një botë plot me brenga e fatkeqësi? Eja, beso në Allahun!

Mbështetu tek Allahu! Buzëqesh në fytyrën e fatkeqësisë; edhe ajo gjithashtu do të buzëqeshë.

Ndërsa buzëqesh, ajo zvogëlohet; do të ndryshohet e transformohet.

Po! Njeriu ashtu siç e zbut, e zvogëlon armiqësinë e zemërimin e armikut të tij kur e pret me gëzim e me pamje të qeshur; madje armiqësia do të transformohej në pajtim e miqësi, dhe kështu armiqësia do të bëhej thjesht si një shaka, do të përfundonte e do të zhdukej, po ashtu në qoftë se njeriu përballet

me fatkeqësinë me mbështetje në Allahun e Gjithëfuqishëm, do të zhdukej ndikimi i saj.

Çështja e Tretë: Çdo shekull ka veçoritë e tij. Në këtë shekull të pakujdesisë, fatkeqësia ka ndryshuar formën e saj. Për disa mosha dhe për disa persona, fatkeqësia në realitet nuk është fatkeqësi, por një mirësi Hyjnore. Meqenëse unë i konsideroj ata që janë goditur me sëmundje në kohën aktuale fatlumë -me kusht që sëmundja e tyre të mos prekë e dëmtojë fenë e tyre, të mos më bëjë ta kundërshtoj sëmundjen dhe fatkeqësinë dhe të mos më bëjnë të ndjej keqardhje për të goditurit.

Sa herë që unë hasja ndonjë të ri të goditur, unë gjeja se ai ishte më shumë i lidhur dhe i interesuar me detyrat e tij fetare dhe me Ahiretin se sa shokët e tij. Nga kjo unë nxora si përfundim se sëmundja nuk përbën një fatkeqësi për njerëz të tillë, por një mirësi nga Allahu, xh.sh.

Është e vërtetë se sëmundja i shkakton atij hidhërim në jetën e tij të shkurtër e të përkohshme të dynjasë, por ajo është e dobishme për jetën e tij të përhershme të Ahiretit. Ajo duhet të shikohet si një lloj adhurimi.

Po, në qoftë se ai djalosh do të ishte i shëndetshëm, nuk do të mundej të ruajë atë gjendje përkushtimi ndaj urdhëresave Hyjnore që kishte në kohën e sëmundjes; madje ai mund të binte në shthurje, si rrjedhojë e vrullit dhe e nxitjes së rinisë dhe natyrës së shthurur të kësaj kohe.



Përfundim

Allahu i Gjithëfuqishëm, me qëllim që të shfaqë fuqinë e Tij të pafund dhe mëshirën e Tij të pakufishme, ka bërë të bashkëlindur, të brendaqenësishme tek njeriu pafuqinë e pafundme dhe nevojën e pakufishme. Për më tepër, me qëllim që të shfaqë qëndisjet e pafundme të Emrave të Tij, Ai e ka krijuar njeriun si një makineri të çuditshme e cila përmban qindra instrumente dhe aparate, ku secila prej tyre ka dhimbje të ndryshme, kënaqësitë, detyrat e ndryshme dhe shpërblimet dhe thevabet.

Thjesht, të gjithë Emrat e bukur Hyjnorë të shfaqur në botë e cila është një njeri i madh gjithashtu kanë manifestime në botën më të vogël që është njeriu. Çështjet e dobishme si: shëndeti i mirë, mirëqenia dhe kënaqësitë e bëjnë njeriun të japë falënderime dhe e shtyjnë makinerinë humane të kryejë detyrat e saj në shumë drejtime, dhe kështu njeriu bëhet si një fabrikë që prodhon falënderime.

Gjithashtu, nëpërmjet fatkeqësisë, sëmundjes dhe dhimbjes dhe nëpërmjet mundësive të tjera nxitëse dhe lëvizëse, rrotat e tjera të makinerisë njerëzore janë vënë në punë e në lëvizje. Mineralet e dobësisë, të pafuqisë dhe të varfërisë të bashkëlindura në

natyrën njerëzore vihen në punë. Kjo nxit tek njeriu një gjendje me anë të së cilës ai kërkon strehim e ndihmë jo vetëm me një gjuhë të vetme, por me gjuhën e secilës prej gjymtyrëve të tij. Kështu nëpërmjet atyre mundësive njeriu bëhet si një laps lëvizës që përmban mijëra lapsa të ndryshëm. Ai e shkruan rrjedhën e përcaktuar të ekzistencës së tij në faqen e jetës së tij ose në pllakën në botën e shëmbëllesës; ai bën një shpallje të Emrave Hyjnorë, ai qëndis një tablo të shkëlqyer të Emrave Hyjnorë; dhe bëhet vetë një poemë për lavdinë e Zotit, xh.sh., duke përmbushur kështu detyrat e natyrës së tij.

